

Andreu për se pari e hasi Simonin, të vëllanë, dhe i tha: “E gjetëm Messinë, domethënë Krish-tin.” Edhe ia sollë Jësújt. Edhe kur e pá Jësúj, i tha: “Ti je Simoni, i biri Jonájti; ti do të quhesh Kefá, domethënë Gur.

## KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp në tërë botën.

## TE KREMTET E DHJETORIT

1. *Naumi, Profeti i Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN NAUMIT, T. IV.

O Naum Profét i Shenjte, që të kremtojmë me besë, nermjetó përpara Zotit, të shpctohen shpirtet tona.

2. *Abakumi, Profeti i Shenjte.*

3. *Sofonia, Profeti i Shenjte.*

4. *Shen Barbara, Deshmorja e Madhe; Joan Damaskeni, Ati ynë Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN BARBARËS, T. IV.

Le të nderojmë Shen Barbaren, se grackat e armikut i dërmój, dhe shpctój prej tyre si një zok, me ndihmën dhe armen e Kryqit e nderúara.

PERLESHORJA E DAMASKENIT, T. T. IV,  
ORTHODOKSIAS ODHIFE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i perkorës je, se na ke ndritur si një yll, dhe

u-tregove si shëmbell e Kryepërfiterve, i urte Damaskén, të gjithë i ndriçove dhe i mesove të, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

*5. Sava i Shenjteruar, Ati ynë Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN SAVES, T. T. IV,  
TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretëtirën e thatë e vadite për lërim, dhe me vajtim dhe psherëtim, gjer një qint herë përc mblodhe për çdo mundim; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndriçove botën me çdo çudi, o Sav' i Shenjtë Atë dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum të o Sav' i Math Ashketi, thesár dhe arke, e shkelqyer e vójtjeve, se Kryqin mi sup e ngrite, dhe Zotit Krisht pas i re, dhe sakrifikove, veten pa kursim; dëshirat e póshtera, trupësore përdhë i shkel, dhe me virtuta, shpirtin tënt e stolis e ngre, dhe me zell qëllor si Parajsen e lartësón. Pra sot ketú po mblídhemi, kremtojmë kujtimin tënt, o Oshenár o Shen Save, dhe të perlotur të lútemi; na mpro pranë Zotit, dhe të gjithëve dhurona, meshire dhe shpëtim.

Ndrit si thëngjill i ndezur në qëll, i frymësuar si Profetët prej Shpirtit Shenjt, në botën fitovë famë, dhe predikove kudó, fjalet e Ungjillit plot me ngazellim; dhe dritën që s' perëndón, e per-

hape kudó mi dhé, dhe shkretctiren e vesove qe lártazi, dhe thengjijt' e saj i flladite çuditerisht. Pra Kryetari Zoti Krisht, kuroren e mündjeve, te ka dhuruar o Atë edhe Parajsen e Çngjçjve; perpara tij mprona, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

Shkalle qe lart ne qellin arrín, o At i Shenjte, na u-çfaqe mi dhene ti, u-ngrite perpara Zotit, dhe me Jesune po flet, Oshenár i lumur Ashketí me nam, dhe driten e qíellit, dhe t' Ungjillit te Zotit Krisht, e predikove, nga tribunat e Kísheve, edhe njérczit i ndriçove me bes' e mall. Pra ne Parajsen je taní, dhe lutesh per gjithe né, qe ta kremtojme kujtimin perunjerisht dhe te lútemi; perpara tij mprona, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

LAVDI, T. II. Sav' Oshenár me nam, virtuta ke lëruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtórevee.

TANI. Çdo shprese me ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj perhér' e ti me mpro.

## PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Çfaqesh ne vogelí, i zgjédhuri i Zotit, dhe en' e shenjteruar, o At i frymesuar, prej Krishtit dhe prej Shpirtit Shenjt.

Kryqin ne dor' e mban, o Ashketí i lumur, dhe djajte dhe demonet, fantazmat dhe kuçedrat, o At' i çkaterrove krejt.

Djajte i shtype krejt, dhe faqebardhe dolle, me Kryqin dhe me Krishtin, edhe u-lavderove, o Ate Oshenár me nam.

LAVDI DHE TANI. Ti gjithenjë na mpron, nga çdo rezík i jetes, nga grackat e armikut, Satanit te pabese, o Save Oshenár me nam.

NDËNJËSORET T. I, TON TAFON SU.

Jetove shpirtërisht, permi dhene o Ate, i paster dhe pa cen, si i zgjedhur i Zotit, si drite udhëqese, e te gjithë besnikëve, pra te lútemi, te nermjetósh prane Krishtit, te shpëtóhemi, o Oshenár i degjuar, Shen Save lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Si nene te Jesújt, qe te gjithë te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né; ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpëtimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

T. T. IV, TIN SOFIAN

More Kryqin e Zotit tone Jesú, edhe pas e vazhdove gjer ne mbarím, dhe prape s' u-ktheve mé, ne qytetet e njëresve, me permbajtje dhe vajtje, pesimet i vrave krejt, dhe e bere trupin tent nje tempull te Shpirtit Shenjt; more pra dhurata, per mundimet e renda, lengatat te na shcrósh, dhe demonet te na i dbosh, o Shen Sav' Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, te na dhuronje

ndjesen e mekátave, neve qe po e kremtojmë, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim te perunjur o Shen Marí, qe ne shqoten e jetes brenda ne det, po rrihet prej ércve, dhe perpiqet prej válave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újve, edhe ne funt te Ferrit, po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpctome dhe shpjerme shpejt, ne limán dhe ne qetesí, se me besë po te therrés: Lutu-i Birit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, se me ty kemi shpresë, gjithë te pavýerit.

#### T. T. IV, TIN SOFIAN

Çdo te mirë te jetes prapa e lé, edhe ndónese kishe trupin mi dhé, u-bere si Engjajtë, edhe rronje ne qiëllin; se per çudí i shove, pesimet e trupit tent, edhe shok i Trinise, u-çfaqë me lumëri; pra shcrón semundjet, dhe lengatat e trupit, dhe dbon çdo demon te lik, me një fjal' e një porrosí, o Shen Sav' Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe sot e kremtojmë, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Ti o portë qellore, o Shen Marí, ti o mali i shenjte plot me shkelqím, o re udhëhëqese, ti o shkallë e qëllshime, ti o Parájs' e méndëshme, per Even shpctónjese, ti o thesár i jetes, i shtrenjte i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjte, ti shpctimin na solle, nga fajet e prínderve, dhe mallkimet e gjýsherve. Perandáj te therre-

sim: Nermjetó pranë Birit tent, te na dhuronjë ndjesen e mekátave, neve që sot e kremtojmë, beserisht kujtimin tent.

### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrah-më dhe shpetomë, o Shpetimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turperoheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, marr jete çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

PARÇVARGU. Vdekja e Oshënarit është e nderuar përpara Zotit.

### UNGJILLI I MËNGJEZIT PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishëpujve: Të gjitha mi ka dorëzuar im Atë; dhe asnjë nuk e njeh Birin përveç Atit; edhe asnjë nuk e njeh Atin përveç Birit edhe atë, të cilit Biri do tja zbulonjë. Ejani tek unë të gjithë të lódhurit edhe të ngarkúarit, edhe unë do tju përç. Ngrëreni zgjedhen time mi veten tuaj, dhe mesoni prej meje që jam i butë dhe i perunjur nga zemra, dhe do të gjëni përçje në shpirtin. Se zgjedha ime është e lehtë.

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI. Me nermjetimet e Oshënarit, o më-

shireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

Sav' Oshenár me nam, virtuta ke lcruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

### SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Prej foshnjërisë, u-blatove si kurbán me mall, dhe me virtutat, shkrepëtive Save Oshenár, për atë që të bekóje për se të lintje. Dhe u-çfaqë, si i par' i Oshenáreve, dhe si kollonizatór i shkretëtirave; të therrës për sot: Lum ti o Ashketí i Math.

### SHTËPIA

Dëshërove urtesinë që prej foshnjërisë, o Save At' i Shenjtë Oshenár, dhe u-ndave prej botes dhe u-ngjite në qell, ku fitove kuroren e pafishkur të Oshenáreve, dhe u-lavderove prej Krishtit në Parajsen e Shenjtóreve. Përandáj, për, të thërrësim sot: Lum' ti o Ashketí i Math.

### SINAKSARI

Me pesë të ketí múaji lusim Saven e Shenjtëruar, Atin tonë Oshenár.

Gjithë sot, kujtojmë Anastasin, Dëshmorin e Shenjtë.

Gjithë sot, Diogjeni, Deshmori i Shenjte, mbaró jeten i vrare me gure.

Gjithë sot, Averqi, Deshmori i Shenjte, mbaró jeten i vrare me shpate.

Gjithë sot, Noni, Ati ynë Oshenár, mbaró jeten ne paqe.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

### ZBRITESORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítene; ja Krishti mi dhene ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

III - A. Perpara nga jetet, lart ne qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjereshes, si nje foshnje u-çfaqë, o Krisht Perendí te fálemi: Ti qe na ngrite perpjetë me nder, o Zot i Shenjte je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulczuar prej Hyjlíndeses, prej mali hieplót, dhe te dendur me lisa, dhe umisherove prej Marise, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Ate me hir, per shpctimin e njérsve Ængjellin, qe paqen perendore sjell, dergove permi dhé; sot pra te udhehequr me drite Perendie, qe menate ngríhemi, dhe lavderojme njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, passi u-gelltít ne det, prej peshkut te math, dolli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpëtimtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyjlíndeses, se u-misherua pa pësím, edhe Nenen e la te pacénshime.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne besemire, trimërisht perbuzne úrdherin e shtýpesit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí atëror, je i bekuar.

VIII - A. Furra vesëplote na tregój nje shembell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnójm' e le t' i fálemi: E bekoni te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartësoni permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistér te çudiçim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubík u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri até qe bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojme pra me kenge sot.

### DËRGIMËSORET, T. III, FOS ANALIOTON

O shkretetire gezohu, dhe lulezó si zambaku, se t' i ka shtuar pallatet, dhe bijte Sava i Shenjte, dhe ti o vend' i Jordanit, kecé dhe ngazellohu, ne ditën e sotme.

Ti o keshtjéll' e florinjte, me dymbëdhjete fortesa, o fron qe ndrit posi díelli, ku Mbreti rri me

Shenjtoret, ti o çudí që s' ke kufí, o Nene Virgjereshe, që Zotin na linde.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Ti që perbuze të mirat e këtij shékulli, dhe pate mall për qellin, edhe për shkretëtirën, o Savë Oshenár të gjithë na fton, ta kremtojmë kujtimin tënt, se pranë Zotit përherë po nermjetón, për shpëtimin e besnikëve.

Në botë s' deshe gjë tjetër përveç virtutëve, me të e lavdërove, përmi dhënë sa vojte, Jesunë Shpëtimtarin me ngazellim, dhe fitovë lavdi në qell, edhe shkrimë lëngatash po na burón, o Shen Sav' Oshenár me nam.

I mir' i matur i butë edhe i embël fort, ke qen' o At i Shenjtë, përmi çdo njeri tjetër, dhe tempull shpirtëror i Zotit Jesú, u-tregovë këtú mi dhé, edhe dhurata shkronjëse po u fal, pasurisht adhurónjesve.

LAVDI, T. II. Sav' Oshenár me nam, në botën u-degjovë, demonet i dermove, dhe Engjëjt' i arrive, dhe shpirtet tona i shpëton.

TANI. Zonjë Hyjlíndese, me lutje pranë Birit, çlirona nga mekatat, shpëtona dhe dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

### SHKURTORJA, T. IV, I PARTHENOS.

Virgjëresha sot po vjen, në Bethlehém për të lindur, Fjalën e perjëshime, brenda në shpellën se fshehti. Vallezó, e tërë bota dyke degjuar, lav-

deró, bashkë me Engjëjt' e me Barinjtc, Perendín' e ameshuar, qe desh të çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

## APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit esht e nderuar perpara Zotit. Si do tja çpagúajme Zotit te gjitha te mirat?

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezer, bándjuni krérove tuaj, dhe dëgjójini; se atá vigjellojne per shpirtet túaja, meqéneqë do te japin fjale per keté gjë; se atehere do ta bëjne me gëzim dhe jo dyke psherëtitur; edhe kjo nuk esht e dobishme per ju. Fáluni per né, se jemi te bindur qe kemi ndergjéggjie te kthjellët, se jemi perpjekur te silllemi mire me te gjithë; dhe mé teper ju lutem ta beni keté gjë, qe te vendosem mé shpejt prane jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti se vdëkuresh barine e math te dhenve, Zotin tone Jesú, me gjakun e dhjates se perjetme, ju stervitte per çdo veper te mire, qe ta mbaroni deshiren e tij, dhe ju befte si ta gjenje te pelqyer me anen e Jesú Krishtit, i cili paste lavdí ne jetet e jéteve. Amín.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohe, Jesúj qendrój ne nje fushe me grupin e Dishépujve dhe me nje shumice te madhe prej pópulli nga e tere Judea dhe nga Jerusalemi dhe nga anedeti i Tyres edhe Sidones, te

cilet kishin ardhur qe ta degjonin dhe te shcróheshin prej semúndjeve dhe demóneve, edhe béheshin te shendoshc. Dhe pópulli i tere deshnin ta preknin; se nje force dilte prej atí, edhe i shcronte te gjithc. Dhe Jesúj i ngriti syte mi Dishépujte, dhe u tha: “Lum’ ju te várferit, se Mbretëria e Perendise eshte júaja; lum’ ju qe jini taní te uret, se do te ngínjeni; lum’ ju qe qani taní, se do te qeshni; lum’ ju, kur njérezit do tju urrejne, dhe do tju çkisherojne, dhe do tju perqeshin, dhe do tjua nxijne emrin per te Birin e njeriut. Gezóhuni até dite, dhe ngazellóhuni, se roga juaj do te jete e madhe ne qell.”

## KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

6. *Shen Kollí.*

### PERLESHORJA E SHEN KOLLIT, T. IV, KANONA PISTEOS

Kanún i bescs, edhe kor’ e butcsise, mesonjes i perkores, ndrite perpara besníkeve, me te verteten e púneve; perandáj i fitove me perunjesine te lartat, me varferine te pásurat. At i lavdcruar Peshkóp Shen Koll, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

### THIRRTORET, T. II, OTE EK TU KSILLU

Myrat i bekove me baním, myrre e vertete u-çfaqe, si u-mirose me shpirt, o kryepeshkóp Shen

Koll, o meshetár i Jesújt, dhe fytyrat ua mirós, atyre që vijne, plot me bes' e pietét për të kremtuar me mall, edhe i shpëtón që të gjithë, prej çdo hidhërimi dhe zie, se përpara Krishtit nermjetón për në.

Mundje sipas emrit luftetár, për besnikun popull u-çfaqë, në ngasje dhe në rezik, o kryepeshkóp Shen Koll, o sherbetór i Jesújt, se kudó që të fton dikúsh, arrín menjëherë, edhe i shpëtón me vrap, dhe mall përíkësit, se përherë ditën dhe natën, i shpëtón me endërr dhe besë, prej rezíkeve dhe ngaterrímeve.

Mbretin Kostandín e lajmerón, bashkë me Ablabin në endërr, i këshillón dhe i trëmp, dhe këshutú i porrosít: Me vrap leshójini, gjith' atá që burgoste sot, pa shkak dhe pa hake, se për vrasjen s' kanë faj se s' kanë bërë asgjé, se sikur të mos i çlironi, lutje do të bënj pranë Zotit, që pas vepres suaj të denóheni.

Ndihmes i palodhur dhe besnik, për nevojat dhe për reziket, je gjithënjé pa dyshím, o kryepeshkóp Shen Koll, o predikonjes i math, permi dhé edhe permi det, për lark e për afer, se i zemërdhempshur je, dhe nermjetón pa kufí, përandáj të mbledhur thërresim, nermjetó për në pranë Zotit, dhe shpëtoji shpirtet e besnikëve.

LAVDI, T. II. O Kryepërít Shen Koll, o meshetár i Zotit, të lútemi degjona, me lutje shigurona, Parajsën e Shenjtóreve.

TANI. Zonjë Hyjlíndese, me lutje pranë Birit,

çlirona nga mekatat, shpetona dhe dhurona, Parajsën e Shenjtóreve.

### PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o Shenjt i parë mi dhé, ti o thesár dhe ti o ark' e virtútave, kanún i shenjteruar i priftërisë Jesújt, dhe barí i mirë i besnikëve; pishtár' i triumfit, i lavdëruar pas émerit, që me meshirë, po perunjesh edhe degjón, të perlúturat e të gjithë lëngónjesve; mprójtësi i të shtëypurve, çlironjes dhe rúajtës, për gjith' atá që po lusin të kremten tende me bes' e mall. Iu-lut Jesú Krish-tit, të na mpronj' e të na fale, meshirë dhe shpë-tím.

Lum' ti o Shenjt i urtë me nam, ti o banesë e Trinisë dhe Çngjçjve, kollón' e fort' e Kíshës, edhe përkrahës besnik, i të raskapíturve dhe të lódhurve; o yll i të mjéreve, që me anën e rézeve, çan erresirën, dhe furtunën e hélmeve, ti që ndrit në qell, o Shen Koll o kryepeshkóp; ti o limán i lúndrave, i qetë i déteve, ku po përikin të mjerët edhe shpëtojnë prej shqótave. Iu-lut Jesú Krish-tit, të na mpronj' e të na fale, meshirë dhe shpë-tím.

Lum' ti o Shenjt i mbushur me zell, që i shpëtove nga një vdekje e túrpshime, atá që ishin dënuar, pa bërë faj dhe më kot, dyke u-fanesur nëpër éndërrat; Shen Koll o kryepeshkóp, o burimi i Mýrave, që pa pushuar, na mirós edhe na vadít, edhe na shpëton prej pesímeve ndótese; draper

që kore égjerat, e gjith' heretikeve, edhe doktrinat e zeza, të Ariosit dhe shókeve. Iu-lut Jesú Krishtit, të na mpronj' e të na falë, meshire dhe shpetím.

LAVDI DHE TANI, T. II. O Shenjt i math me nam, njerí i Perëndisë, dhe meshetár i Krishtit, edhe kollón' e Kishes, pa prerë nermjetó per né.

#### NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

Shkelqeve përmí dhé, me çudí dhe me reze, Shen Koll peshkóp i math, dhe levize çdo gjuhë, për kengë dhe për lavderím, të Jesújt që të lavderójt; pra atí iu-lut, të na shpetonjë përherë, prej rezíkeve, né që me mall të nderojmë, i zgjedhur i Aterve.

LAVDI DHE TANI. O Zonjë Shen Marí, en' e shenjte e Zotit, na ngrer dhe na shpetó, né që humpme çdo shpresë, që vdesim dhe mbýtemi, nëpër llomat e fájeve; ti e vetëm je, shpetím i çdo mekatari, ti je ndíhmese, dhe ti je mprojtje e fortë, e gjithë besníkeve.

#### T. IV, EPEFANIS SIMERON

Ti u del besníkeve, mprojtes përher' o i lumur, dhe prej gjithë hélmeve, po i shpetón me dhempsherí, o bukurí e Shenjtóreve, Shen Koll i ndriçim, lavdí e besníkeve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprojtëse, për çdo nevojë, nermjetó për gjithë né, që kemi

shprese permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besníkeve.

#### T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Si mprojtes i Kísheve, te Shpetimatrit Jesú, u-çfaqe Shen Koll i math, rezove plot me kuxím, doktrinat e shtrémbera; theve heretiket, dhe kanún u-tregove, ndrite gjith' Orthodoxset, dhe pa prere po lutesh, perpara Krishtit per te gjithë, besniket dhe pasónjesit.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Hyjlíndese, kerkesat tona i prit, dhe shpjer-i te lútemi, perpara Birit Jesú, dhe Zotit te qíellit; nxirna nga çdo shtrengese, se me ty perikim, thýeji te paudhet, dhe dermoji armiqte, qe na leftojne pa prere, ti o mprojtje e besníkeve.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohej ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerísht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARÇVARGU. Vdekja e Oshenarit esht e nderuar perpara Zotit.

## UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, që i kishin ardhur: “Me të vertetë, me të vertetë po ju them: Aý, që nuk e hyn nga dera në hoborrin e dhënve, po ngjitet gjétkazi, aý është vjedhës edhe kusár, edhe aý, që hyn nga dera, aý është bariu i dhënve. Atí ia hap derën portari, dhe aý i therrét me emër dhentë, dhe i nxier jashtë. Dhe kur i nxier jashtë dhentë, barét përpara atyre, dhe dhentë i vënë pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vënë pas një të húaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin të húajve.” Këtë parabolë ua tha Jesús, po nuk i múarën vesh ató, që u thoshte. Jesús, pra, u tha perserí: “Me të vertetë, me të vertetë po ju them se unë jam dera e dhënve. Të gjithë atá, që kanë ardhur përpara meje, janë vjedhës edhe kusarë, edhe dhentë nuk i degjuan. Unë jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hyjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotje.”

*Psalmi 51 pa zë.*

LAVDI. Me nermjetimet e Kryepërfittit, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhësít' e mia.*

T. II. Lum' ti o Kryepërfitt, o punitór i vreshtes, që solle për më shumë, hyr në gezím të Zotit, Shen Koll dhe nermjetó për në.

## SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

O Shen Koll i Mýrave, kryepeshkóp u-tregove, porrosít' e Zotit Krisht, sipas Ungjillit i permbushë, shpirtin tent, për besniket e dorzove; pópullin, nga çdo rezik e shpëtove; perandáj u-shenjterove, me hir të Zotit, o Kryepriфт i Math.

## SHTEPIA

Le ta lavdërojmë Shen Kollin, barinç dhe mesónjesin e Mýrave, meshëtarin e kulluar nga shpirti dhe nga trupi, nermjetarin e palodhur përpara Krishtit, mprójtësin dhe perlufëtarin e Kishës, që u-shenjterua me hir të Zotit, si Kryepriфт i Math.

## SINAKSARI

Me gjashtë të ketí múaji, kujtojmë Shen Kollin, Atin tonë, Kryepeshkopin e Mýrave të Likisë, çudibéresin.

Me nermjetimet e tij, o Perëndí, meshirona. Amín.

## ZBRITËSORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavdërójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítëni; ja Krishti mi dhënë ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazëllime, përhyrnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

III - A. Përpara nga jetët, lart në qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjërshës, si një foshnjë u-çfaqë, o Krisht Perëndí të

fálemi: Ti që na ngrite përpjetë me nder, o Zot i Shenjtë je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulëzuar prej Hyjlíndesës, prej mali hieplót, dhe të dendur me lisa, dhe u-misherove prej Marisë, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Atë me hir, për shpëtimin e njëresve Engjellin, që paqen perëndore sjell, dërgove përmi dhé; sot pra të udhëhequr me dritë Përendie, që menatë ngrihemi, dhe lavderojmë njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, pasi u-gëlltít në det, prej peshkut të math, doli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpëtimtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyjlíndesës, se u-misherua pa pësím, edhe Nenen e la të pacénshime.

VII - A. Tre Djemat që u-rritnë besmire, trimërisht përbuznë úrdherin e shtëpsit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po në flagë dhe në prush, me këngë fáleshin: O Perendí atë-rór, je i bekuar.

VIII - A. Furra vesëplote na tregój një shembell, të çudisë që shkeli natyrën, se ajó s' i dogji Tre Djemat që priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnójm' e le t' i fálemi: E bekoni të gjithë Zotin me zë të math, dhe e lartësoni përmi të gjitha jetët.

IX - A. Mistër të çudiçim, shikónj dhe s' e

marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubík u-çfaq Virgjeresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri até qe bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojme pra me kenge sot.

### DERGIMCSORET, T. II, TIS MATHITES

Te gjithë le te mblídhemi, Shen Kollin ta kremtojme, Peshkopin e Myréasve, meshctarin e lumur, se ka shpetuar nga vdekja, njérezit e pafajme, kur iu-fanés ner énderrat, Mbretit edhe Ablabit edhe u tha, t' i lëshonin njérezit menjehere, se ndryshe do denóheshin, per keté faj te rende.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i erresírave, mprona perpara gjyqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjereshe, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dorë.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Si zok mi lulet e Kishes po fluturón perqárk, qe nga foléj' e larte, engjellore e qellit, Shen Koll tri her' i lumur ti nermjetón, prane Zotit per gjithë né, dhe na shpetón nga çdo ngasje dhe çdo rezík, dhe prej gjithë mjerímeve.

E zbukurove mantellen tende o Kryeprift, me vepra dhe virtuta, e shkelqeve me drite, o At' i Shenjteruar pra veperón, çdo çudí edhe çdo she-

rím, për çdo lëngát' e sëmundje dhe na shpëtón, prej të gjithë mjerimeve.

Me bukuritë qellore dhe të padúkura, ke qenë i rëthuar, dhe kështu kuptove, lavdirat e verteta o Kryepërfít, o Shenjtór i Shenjtóreve, dhe përandáj gjithënjë po na lajmëron, predikimet e Engjëjve.

Në enderr natën iu-dukë Mbretit mëshirëplót, prej vdekjes i shpëtove, hapsaniket e mjerë; kështu pra nermjetó për në gjithënjë, gjithashtu të shpëtóhemi, nga çdo rezík dhe shtrengicë dhe psherëtim, në besniket dhe këndónjesit.

LAVDI, T. T. I. Bjëruni trumbëtave, dhe mblídhuni të gjithë për të kremten e Kryepërfítit. Mbretër edhe krerë, barínj edhe mesonjës, lavderójeni me këngë të gjithë: Të sëmurët mjekun; mëkatarët nermjetarin; të vërferit thesarin; të hidhëruarit ngushëllimtarin; udhëtarët udhëhëqesin; lundrëzónjesit kapëdanin. Të gjithë le të thërresim me një zë: Shen Koll nermjetó përpara Krishtit, edhe shpëtona prej rezíkeve dhe hëlmeve.

TANI. O Marí Hyjlíndëse, Nën' e Zotit Krisht, edhe perikje e gjithë të Krishtëreve, nermjetó përpara Birit tënt, edhe vlerësona për Mbretërinë qellore.

#### SHKURTORJA, T. IV, I PARTHENOS

Virgjëresha sot po vjen, në Bethlehém për të lindur, Fjalën e përjëtshimë, brenda në shpellën

se fshehti. Vallezó, e tere bota dyke degjuar, lavenderó, bashke me Ëngjejt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

## APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit esht e nderuar perpara Zotit. Si do tja çpagúajme Zotit te gjitha te mirat?

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezer, bínjuni kréreve tuaj, dhe degjójini; se atá vigjellojne per shpirtet túaja, meqéncqé do te japin fjale per keté gje; se atehere do ta bejne me gezím dhe jo dyke psherctitur; edhe kjo nuk esht e dobishme per ju. Fáluni per né, se jemi te bindur qe kemi ndergjégjie te kthjelllet, se jemi perpjekur te sillemi mire me te gjitha; dhe mé teper ju lutem ta beni keté gje, qe te vendosem mé shpejt prane jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti se vdékurçsh barine e math te dhenve, Zotin tone Jesú, me gjakun e dhjates se perjetme, ju stervitte per çdo veper te mire, qe ta mbaroni deshiren e tij, dhe ju befte si ta gjenje te pelqyer me anen e Jesú Krishtit, i cili paste lavdí ne jetet e jéteve. Amín.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohë, Jesúj qendrój ne nje fushe me grupin e Dishépujve dhe me nje shumice te madhe prej pópulli nga e tere Judea dhe nga Jeru-

salemi dhe nga anedeti i Tyres edhe Sidones, të cilet kishin ardhur që të degjonin dhe të shëröheshin prej semëndjeve dhe demoneve, edhe bëheshin të shendoshe. Dhe pópulli i tere deshnin ta preknin; se një force dilte prej atí, edhe i shëronte të gjithë. Dhe Jesúj i ngriti sytë mi Dishëpujte, dhe u tha: “Lum’ ju të vërferit, se Mbretëria e Perendise është júaja; lum’ ju që jini taní të urret, se do të ngínjeni; lum’ ju që qani taní, se do të qeshni; lum’ ju, kur njërezit do tju urrejne, dhe do tju çkisherojne, dhe do tju perqeshin, dhe do tju nxijne emrin për të Birin e njeriut. Gezóhuni até dite, dhe ngazellóhuni, se roga juaj do të jetë e madhe në qell.”

## KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

7. *Ambrosi, Ati ynë i Shenjte, peshkopi i Milanit.*

### PERLESHORJA E SHEN AMBROSIT, T. IV, KANONA PISTEOS

Kanún i besës, edhe kor’ e butesise, mesonjes i perkores, ndrite përpara besnikëve, me të verteten e púneve; perandáj i fitove me perunjesine të lartat, me varferine të pásurat. At i lavderuar Peshkóp Ambrós, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

8. *Patapi, Ati ynë Oshenár.*

9. *Zenia e Shen Annes, gjyshes së Krishtit.*

## PERLESHORJA E SHEN ANNES, T. IV.

Sot po zgjidhen vargonjtë e palindjes, se Zoti degjój Joakimin dhe Annën, dhe zotohet tu japë një bijë, Shen Marinë Virgjreshën, prej se ciles lindi vetë i papershkrúari, kur u-bë njerí; peran-dáj i thirri Gngjelli me ze të math: Gezohu o Hir-plote, Zoti është me ty.

## PERLESHORJA E DANIELIT STILITIT,

*10. Mináj Kalikelladi, Hermogjeni dhe Eugrafi, Deshmoret e Shenjtë.*

## PERLESHORJA E MINAJT KALIKELLADIT, T. IV, EPEFANIS SIMERON

Të rrembeu lart në qell, Zoti nga dheu, jetën tjetër ta dhurój, në Mbretërinë o Miná, bashkë me shokët që kishe pas, dhe trashëgove, kurorën e pafishkur.

*11. Danieli Stiliti, Ati ynë Oshenár.*

## T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Kollón' e patúndeshmë, e Kishes o Daniél, kandíl i pashúarshmë, i tërë botes o Shenjt, u-çfaqë plot me lavdí; ndrite mi tërë dhënë, me deshmím e me vajtje, shove dhe paganizmen, e mallkuar dhe t' erret. Pra lutu pranë Zotit Krisht, të shpëtohen shpirtet tona.

## E DIELA E STERATERVE

*(Që me 11-17 të Dhjetorit)*

## PERLESHORJA E STERATERVE, T. II.

Me besën i drejtesovë Steráterit, kur u-vlove

me Kishen prej Gjentëve; pra mburren Shenjtoret me lavdi, se prej atyre ka lindur, Nena jote Virgjreshë. Me lutjet e tyre, meshirona o Krisht Perëndi.

## SINAKSARI

*Passi kendohet Sinaksari i dites se muajit, shtohet edhe i Steráterve:*

Gjithe sot, kujtojme Steráterit e Shenjte.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndi, meshirona. Amin.

*Kendohen Zbritesoret e para (A) te Kershendëllave:*  
ZBRITESORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítene; ja Krishti mi dhene ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdi.

III - A. Perpara nga jetet, lart ne qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjreshes, si nje foshnje u-çfaqe, o Krisht Perëndi te fálemi: Ti qe na ngrite perpjete me nder, o Zot i Shenjte je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulczuar prej Hyjlíndcses, prej mali hieplót, dhe te dendur me lisa, dhe umisherove prej Marise, dhe linde o Perëndi: Zoti i fuqishim lavdi me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Ate me hir, per shpeti-

min e njëresve Engjellin, që paqen perendore sjell, dergove permi dhé; sot pra të udhëhequr me dritë Perendie, që menatë ngrihemi, dhe lavderojmë njeridashësin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, pasi u-gëlltít në det, prej peshkut të math, doli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpëtimtár, shkoj nga gjir' i Virgjërshes dhe Hyjlíndeses, se u-mishërua pa pësím, edhe Nenen e la të pacëshime.

VII - A. Tre Djemat që u-rritën besëmire, trimërisht përbuzën úrdherin e shtëpsit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po në flaqe dhe në prush, me kengë fáleshin: O Perendí atëror, je i bekuar.

VIII - A. Furra veshplote na tregój një shembell, të çudisë që shkeli natyrën, se ajó s' i dogji Tre Djemat që priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjërshen aspák. Pra le ta hymnojím' e le t' i fálemi: E bekoni të gjithë Zotin me zë të math, dhe e lartësoni permi të gjitha jetet.

IX - A. Mistër të çudiçim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell një shpellë ndrit; frón Kerubík u-çfaq Virgjërshen; dhe grazhdi i vogël, e nxuri atë që bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madhështojmë pra me kengë sot.

## DERGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Kujtimin e Steráterve, kremtojmë sot me valle, pra o besnikë mbliðhuni, Abrahamin hym-

noni, Jakobin dhe Isaakun, se prej atyre ndriti, shpëtimi i besnikëve, në një shpellë të varfër në Bethlehém, dhe u-prit prej Engjëjve dhe barinjve, me këngë mireprítëse, nga qelli dhe nga dheu.

### LAVDGRIMET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Mblídhuni sot ketú, kujtójini me besë, Steráçtërit e Shenjte, kremtójini me këngë, me bujë dhe me brohorí.

Shkelnë furren me zjarr, Tre Djemat e bekuar, dhe valle brenda losnin, dhe hymne po këndonin, për Perendín' e Aterve.

Brenda në grop' u-hoth, me bishat dhe luanet, Profeti Danieli, dhe mbeti i pangarë, me mprojtjen e krijónjesit.

LAVDI. Eni këndójeni, Profetin Isaia, që tha për Virgjreshen, që do të lindë Krishtin, shpëtimin e besnikëve.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlíndëse Virgjreshë. Të hymnojmë, se prej Birit që lindë, Ferri u-roberua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe në muarëm jetë. Përandáj po hymnojmë, dhe thërresim: I bekuar je, o Krisht Perendí, që e pelqeve kështú, lavdí me ty.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjresha sot po vjen, në Bethlehém për të lindur, Fjalën e perjëshime, brenda në shpellën së fshehti. Vallezó, e tërë bota dyke degjuar, lav-

deró, bashke me Gngjejt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

## APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perendí i Aterve tane. Se na i bcre te gjitha me te drejte.

Prej Letres se Palit per Korinthianet.

Vellezer, kur te çfaqet Krishti, jeta jonc, atehere edhe ju do te çfaqeni me lavdí bashke me até. Pra, mbýtini te gjitha pasionet e permidhëshme dhe dëshirat e liga dhe lakmimet, te cilat e zemerojne Perendine kunder bijve te pabindjes, dhe ne te cilat kini ecur nje here, kur rronit ne e-rrësiren e paganizmes. Po taní hídhini te gjitha merite, zemerimet, ligesite dhe blasfemite nga zemra juaj. Mos genjeni njerjatrín, se e kini çveshur roben e njeriut te vjeter me te gjitha punet e tij, edhe taní kini veshur roben e njeriut te ri, dhe jini perseritur pas kores se Zotit, i cili ju ka krijuar, atjé ku nuke ka Grek edhe Jahudí, rethprerje dhe parethperrje, barbár edhe Skith, rob edhe te lire, po ne te gjitha dhe mi te gjitha eshte Krishti.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

Zoti tha keté parabolle: Nje njerí beri nje darke te madhe, edhe ftoj shume veta, edhe dergój sherbetorin ne kohen e darkes qe tu thoshte te ftuarve: "Ejani, se te gjitha jane gati." Dhe me

nje fjale nise te hiqen te gjithë. I pari tha: “Kam blere nje are, dhe do te vete ta shikonj. Te lutem, quaj-me te hequr.” Edhe tjatri tha: “Kam blere pese pende qe, dhe do te vete t’ i provonj. Te lutem, quaj-me te hequr.” Edhe tjatri tha: “Jam martuar, dhe nuke munt te vinj.” Edhe u-kthye sherbetori, dhe ia lajmeroj ketó te gjitha zotit. Atchere u-zemerua i zoti i shtepise, edhe i tha sherbetorit: “Shko shpejt ne rugat edhe ne she-shet e qytetit, edhe sill-i ketú brenda te varferit edhe uloket edhe te çalet edhe te vérberit.” Edhe sherbetori i tha: “Zot, kam bere siç me urdhero-ve, po ka vent édhe.” Edhe Zoti i tha sherbetorit: “Shko ner ulicat edhe gjerdhet, edhe shtrengoji te gjithë te vijne gjer sa te mbushet e tere shtepia. Se po ju them qe asnjé nga te ftúarit nuke do ta ngjeronje darken time. Se te ftúarit jane te shumet, po te zgjédhurit jane te paket.”

12. *Shen Spiridoni.*

PERLESHORJA E SHEN SPIRIDONIT,  
T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Perluftari i Sinodit te pare u-tregove, edhe çudiberes hyjprures, o Spiridón i Shenjte; i fole se vdékures ne varr, dhe gjárperin e zi e bcre ar; dhe n’ Alltarin kur sherbenje per Zotin Krisht, me Engjejte tok meshonje; lavdí atí qe te lavderój, lavdí atí qe te dha kurorc, lavdí atí qe veperój, me anen tende shcrime.

## THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o Kryeprift shembellór, ti o kollonc, e patundur e Kísheve, lavdí e Orthodoxise, qe ke buruar çudí, lum' i dashurise, qe po rjeth per né; o yll qe shkelqén dhe ndrit, instrumenti i Shpirtit Shenjt, mendje qellore, zemerbutc me hir dhe nder, i stolísuri me virtút e perunjési; o meshetár dhe Shenjt me nam, o Engjell i qiellit, o punctór i vreshtes, o mik i fjeshte i Zotit Krisht; pra lutju pa prere, qe besníkeve tu fale, meshire dhe shpetím.

Dhenc dhe qellin e trashegón, si zemerbutc, qe u-çfaqe ner njérczit, o Ate i lavderuaur, qe me fuqí dhe me ment, dhe me fjale t' urta, dhe me hir qellór; armikun e Zotit Krisht, Ariosin e lik pa ment, e shtype fare, edhe besen e hýjeshme, dhe shpetónjese, lart e ngrite me Shpirtin Shenjt; ti u tregove Kísheve, me drit' e me predikím, ta lavderojne Jesunc, te bashkeqenshim ne nje Triní; me Atin pa nisje, qe i fali tere botes, meshire dhe shpetím.

Vrave pcsimet brenda ne trup, edhe i ngjalle, qe prej varrit te vdékurit, dhe gjárperin ar e bere, edhe qendrove luménj, me fuqín' e Zotit me te fálura; edhe naten iu-duke, ne enderr Mbretit qe ish ne shtrat, dhe e shrove, nga semundj' e rezíkshime, edhe Zot' i Math, me çudira te lavderój; pra me nje buj' e brohorí, kujtimin ta lusim sot, edhe lipsanet e tua, i adhurojme me bes'

e mall. Ató na burojne, mjekesine per lengatat, meshire dhe shpetim.

LAVDI, T. I. Ate Oshenár i lumur, Spiridón i urte, e pyete te vdékuren; e bere gjárperin florí; e shcrove mbretin ne enderr, pra nermjetó perpara Krishtit, per shpetimin e shpírteve.

TANI. Shpelle pregatitu, se Virgjeresha vjen per te lindur Krishtin. Barinjte e presin me fyell, Maget i siellin ar liván dhe smirne. Besnike príteni, me buje dhe me brohorí.

#### PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ate Shen Spiridón, ne darke sot i ftove, besniket t' i gostitesh, me gjelle shpirterore, per ndjesen e mckátave.

Ndrite me çdo virtút, shkëlqeve me çudira, ne Kishet predikove, dhe boten e ndriçove, si díelli i Zotit Krisht.

Ngrite te vdékuren, dhe lumin e qendrove, dhe mbretin e shcrove, dhe gjárperin e ndrove, ne ar o Spiridón o Shenjt.

LAVDI DHE TANI. Shtype çdo heretík, dhe Kishen e forcove, çudira vepcrove, pra lutu pran Krishtit, per ndjesen e mckátave.

#### NDENJGSORET, T. III, TIN OREOTITA

E ndrove gjárperin, e bere ar o Shenjt, dhe me llogjik' e ment, i shtype ploterisht, gjith' heretiket beselíq te lidhur me Ariosin. Edhe mbretin e sherón, si nje mjek i lengátave, dhe i ngjall te

vdékurit, dhe largón çdo demón dhe djall, ketú pra te permbledhur hymnojmë, ditën tende te shenjte o Kryeprift.

LAVDI DHE TANI. Zonje Hyjlíndese, Nena e Zotit Krisht, shpirtin që m' u-semúr, eja dhe ma shëró, se jam i mbytur plotërisht prej fájeve Virgjereshe; ty pra te therrés me mall, dhe me zemer renkónjese, prit-me e panjóllshime, mekatarin vajtónjesin, që po te pershendósh posi Engjelli: Gezohu o Zonje Hirplote.

#### T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Stolise me predikím, Kishen e Zotit Krisht, nderove me veperím, te gjithë njërczit, i lumur Shen Spiridón; ndrite në tere boten, si nje yll urtesie, hir dhe shkrimet fale, per te gjitha lengatat, te gjithë pra kremtojmë, kujtimin tent o Kryeprift.

LAVDI DHE TANI. O shpres' e besnikëve, që kanë besë me ty, o Zonje Hyjlíndese, o Virgjereshe Marí, o Nena e Zotit Krisht; lutju tok me Shenjtoret, dhe me gjith' Apostujte, paqen edhe meshiren, tere botes t' i fale, dhe neve që te lusim, Parajsen e Shenjtóreve.

#### T. T. IV, TIN SOFIAN

Në pallatet e Kishes po predikón, në Sinodet e Shenjta po keshillón, Trinine shpëtónjese, e shpjegove me ment kudó. Edhe në boten leçite, që kemi nje Perendí, ndare në tri persona bash-

kuar ne nje Triní; pra me aresye, frymesuar prej Zotit, e shtype perçáresin, Ariosin me Shpirtin Shenjt; o i lumur Shen Spiridón, lútu-i Jesújt Perendí, te na dhuronje ndjesen e mekátave, sot qe kremtojme te gjithë, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Ti o porte qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjtc plot me shkelqím, o re udhehéqese, edhe shkalla e qëllshime, ti o Parájs' e méndeshme, per Even shpetónjese, ti o thesár i botës, i shtrenjte i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjte, ti shpetimin na solle, nga fajet e prínderve, dhe mallkimet e gjýsherve. Perandáj te therresim: Nermjetó prane Birit tent, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe sot e kremtojme, beserisht kujtimin tent.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartsohet ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARÇVARGU. Goja ime do te flase urtesí, dhe zemra ime kupctím.

## UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, që i kishin ardhur: “Me të vertetë, me të vertetë po ju them: Aý, që nuk e hyn nga dera në hoborrin e dhënve, po ngjitet gjétkazi, aý është vjedhës edhe kusár, edhe aý, që hyn nga dera, aý është bariu i dhënve. Atí ia hap derën portari, dhe aý i thërrét me emer dhentë, dhe i nxier jashtë. Dhe kur i nxier jashtë dhentë, barét përpara atyre, dhe dhentë i vënë pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vënë pas një të húaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin të húajve.” Këtë parabolë ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, që u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: “Me të vertetë, me të vertetë po ju them se unë jam dera e dhënve. Të gjithë atá, që kanë ardhur përpara meje, janë vjedhës edhe kusarë, edhe dhentë nuk i degjuan. Unë jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hyjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotjë.”

*Psalmi 51 pa zë.*

LAVDI. Me nermjetimet e Kryepërfetit, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhësít' e mia.*

T. II. Atë Shen Spiridón, kollón' e Krishterimit, përpara Krishtit lutu, përkrahna shiguro-na, Parajsen e Shenjtóreve.

## SHKURTORJA, T. II, TA ANO

Nga mall' i Jesújt, u-ndeze o Kryeprift, u-ngjite në qell, në driten e Shpirtit Shenjt, me teorí praktike, mbarove vepren e ndrícime, e-dhe u-bere therore e hýjeshme, dhe driten u fale gjithë njërcsve.

## SHTËPIA

Le ta lavderojmë Shen Spiridonin, Kryepriftin e Zotit, që ndrit me hirin e lavdisë qellore, dhe mori nam në tërë botën me çudirat, që i shpëtón mekatarët, edhe i mpron të váfërit, që ka sherbyer si meshetár në alltarin e Krishtit, edhe u fali driten gjithë njëresve.

## SINAKSARI

Me dymbëdhjetë të ketí múaji, kujtojmë Shen Spiridonin, Atin tonë, Kryepeshkopin e Trimituntës, çudibéresin.

Gjithë sot, kujtojmë Sinetin, Deshmorin e Shenjtë, Atin tonë, kryepeshkopin e Jerusalemit.

Gjithë sot, kujtojmë Amonathane dhe Anthin, Aterit tanë Oshenárë.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndí, meshirona. Amín.

*Kendohen Zbritesoret e para (A) të Kershendëllave:*  
ZBRITËSORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i

qellit vjen dilni priteni; ja Krishti mi dhenc ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

III - A. Perpara nga jetct, lart ne qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjreshes, si nje foshnje u-çfaqe, o Krisht Perendí te fálemi: Ti qe na ngrite perpjete me nder, o Zot i Shenjte je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulczuar prej Hyjlíndeses, prej mali hieplót, dhe te dendur me lisa, dhe u-misherove prej Marisc, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Ate me hir, per shpetimin e njéresve Engjellin, qe paqen perendore sjell, dergove permi dhé; sot pra te udhchequr me drite Perendie, qe menate ngríhemi, dhe lavderojme njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, passi u-gelltít ne det, prej peshkut te math, dolli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpetimtár, shkoj nga gjir' i Virgjreshes dhe Hyjlíndeses, se u-misherua pa pesím, edhe Nenen e la te pacénshime.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne bescmire, trimérisht perbuzne úrdherin e shtýpsit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí atec-rór, je i bekuar.

VIII - A. Furra veseplote na tregó j nje shem-bell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnó j m' e le t' i fálemi: E bekoni te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartesoni permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistér te çudiçim, shikón j dhe s' e marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubík u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri até qe bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojme pra me kenge sot.

### DERGIMESORET, T. III, EPESKEPSATO

Prej kopese pa gjykím, te shpuri Shpirti Tere-shénjt, ne t' arçsyshmen si barí, si Moisi dhe si Davíd; ketá i imitove pra, me fjale dhe me pune, o drite o Spiridón.

Na linde o Hylíndese, Jesune Krishtin Perendí, qe tere boten e shpetó j, me Ngjalljen e tridíçime; shpetona nga semundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémpshura.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Prej Shpirtit Shenjt i ndriçuar o Kryepríft i Math, e shove heresine, t' Ariosit te erret, me gjithë blasfemít' e prallat e tij, dhe Trinine po na leçít, dhe lavderohesh prej te gjithëve vleresísh, si nje yll i Sinódeve.

Si u-ndriçove prej qellit o Kryepríft i Math, dhe me fuqín' e Krishtit, po sherón çdo lengate,

te shpirtit dhe te trupit per gjith' atá, qe kremtojne kujtimin tent, o At' i lumur çudibéresi Spiridón, na kujtó dhe nermjetó per né.

Si punctori i vreshtes besník i Zotit Krisht, u çfaqe qe menate, porrosít' i mbarove, andáj pra Mbretërine lart trashegón, si çperblím te mundímeve, pra nermjetó pa pushuar per gjithë né, qe te lusim o Spiridón.

LAVDI, T. II. Shove çdo heretík, dhe Kishen e forcove, çudira veperove, pra lutu pa pushuar, per shpirtet e besníkëve.

TANI. Zonje Hyjlíndese, me lutje pranë Birit, çlirona nga mekatat, shpetona dhe dhurona, Parajsen e Shenjtoreve.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjëresha sot po vjen, në Bethlehém per te lindur, Fjalën e perjétslime, brenda në shpellën së fshehti. Vallezó, e tërë bota dyke degjuar, lavdëró, bashkë me Çngjajt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

### APOSTULLI

Oshenaret do te mburren me lavdí. Kendójini Zotit një kenge te re.

Prej Letres së Palit per Efesianet.

Vellezer, barisni si bij te drites, se miresia dhe drejtesia dhe e verteta janë pemët e Shpirtit të Shenjtë, dhe vëzhgoni gjerat e pelqýera prej Zo-

tit. Edhe mos u-shoqeroni me veprat e papémeta te erresires, po i qertoni mé teper, se ató, qe po bëjne fshéhtazi, nuke tregohen me gojc. Edhe ató, te cilat qertohen, çfaqen prej drites, edhe te gjitha ató, qe çfaqen, jane drite. Perandáj Shkriptura thote: “Ngrehu ti, qe fle, dhe ngjallu prej se vdékuresh, dhe do te ndriçonje Krishti.” Kini mendjen, pra, dhe barisni me kujdés, jo si te paditur po si te ditur, dyke pergjuar kohen, se ditet jane te keqia. Perandáj, pra, mos u-beni te çmendur, po kupetoni seç’ eshte dashuria e Zotit. Edhe mos u-dehni me vere, se kjo eshte nje prodigerí, po mbúshuni me Shpirtin e Shenjte, ligjeroni psallme dhe hymne dhe kenge shpirtërore, edhe kendójeni, dhe lavderójeni Zotin me zemren tuaj.

### UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti tha: Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje. Kusari nuke vjen veçse per te vjedhur, per te therrur dhe per te humbur, po une kam ardhur qe tju jap jete dhe tju jap jete te teper. Une jam bariu i mire. Bariu i mire ve shpirtin per dhente. Po rogetari, i cili nuk eshte barí, dhe nuk i ka te tija dhente, e sheh ujkun, qe vjen, edhe i le dhente, dhe iken, dhe uku i rembén, edhe i çkaterrón dhente. Dhe rogetari iken, se eshte rogetár, dhe nuk e ha malli per dhente. Une jam bariu i mire, dhe i njoh te miat,

edhe të miat më njohin. Sikunder më njeh im Atë, edhe unë e njoh Atin, edhe ve shpirtin për dhentë. Kam edhe dhen të tjera, që nukë janë prej këti hoborri, edhe duhet t' i siell edhe ató; edhe do ma degjojnë zerin, edhe do të bëhen një kopë dhe një barí.

### KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

13. *Strati, Auksenti, Eugeni, Mardari dhe Oresti, Deshmoret e Shenjte; Lukia Virgjeresha, Deshmorja e Shenjte.*

14. *Thirsi, Lefqi, Kaliniku, Filemoni, Apolloni, Arriani dhe shoket e tij, Deshmoret e Shenjte.*

15. *Shen Lefteri, Hierodeshmori i Shenjte.*

### PERLGSHORJA E SHEN LEFTERIT, T. IV, QË TROPON METOKHOS

Shok i mënyrave, nëkembës i frónëve, u-çfaqë kor' e Dishépujve, zbatove me vepërím kudó, çdo teorí edhe predikím; përandáj të verteten e leçite prer' e drejt dhe për besën leftove gjer në gjak, si një Deshmór o Shen Leftér; lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

16. *Hagaj, Profeti i Shenjte; Theofanoja, Mbretresha e Shenjte dhe çudibérese.*

### PERLGSHORJA E SHEN THEOFANOSË, T. IV, O IPSOTHIS

Permi të gjitha preferove qelloret, Theofanó o Mbretcrësh' e degjuar, dhe si një Engjell jeten e ke shkuar mi dhé; Zoti pra të vleresój, për gëzi-

met e qellit, tok me gjithë Engjajtë, dhe me gjithë Shenjtoret, përpara Mbretit tonë Jesú Krisht; atí pra lutju, që të gjejme përdellím.

17. *Danieli, Profeti i Shenjte, dhe Anania, Azaria, Misaili, te Tre Djemat e Shenjte; Dionisi, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Egines.*

## PERLESHORJA E DANIELIT, T. IV.

### MEGALLA TA TIS PISTEOS

Çudira të mëdhá bes' e forte po mbarón; në furrë dhe nëper zjarr, si nëper újera të flladítura, Tre Djemat e denuar gëzoheshin; edhe Profeti Daniél, në shpellen u-çfaq, si barí i luáneve. Dhe atá po të luten o Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

*Perleshorja e síperme këndohet edhe të Díelen Përpara Kershendéllave.*

## PERLESHORJA E DIONISIT TË EGINGS, T. I., TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Të birin e Zakinthes dhe peshkopin e Egings, rójtesin besnik të Strofades, të gjithë le ta lusim, me këngë të Shenjtin Dionís, dhe le ta lavderojmë pa pushím. Né besniket që kremtojmë me brohorí, shpëtona se të thërresim: Lavdí atí që të lavderój; lavdí atí që të fali çudirat; lavdí atí që na dhurój një nermjetár të palodhur.

## E DIELA PËRPARA KERSHENDËLLAVE

*(Që më 18-24 të Dhjetorit)*

## PERLESHORJA, T. IV, MEGALLA.

Çudira të mëdhá bes' e forte po mbarón; në

furre dhe neper zjarr, si neper újera te flladítura, Tre Djemat e denuar gczóheshin; edhe Profeti Daniél, ne shpellen u-çfaq, si barí i luáneve. Dhe atá po te luten o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

### THIRRTORET, T. I, PANEFIMI.

O Zonje dhe Nen' e Zotit Krisht, o pallát i Engjejve, até qe qiélli nuk e nxe, ti ne grazhd e mban; brenda ne nje shpelle, linde te perjétsimin, qe zbriti posht' e u-be njerí, dhe u-perúnj mi dhé, qe t' i ngrere te rrezúarit, prej mekatit, ne pusí te gjárperit.

U-shkrove o Zoti Jesú Krisht, si nje rob i Késarit, nga perdellimi pas úrdherit, ardhe te na dhurósh, hirin dhe lirine, jeten dhe shpetimin tent, gjithë besníkeve pa ndryshím, dhe adhurónjesve, dhe ne shpelle lart nga qiélli, zbritë poshte, per shpetím te njéresve.

Kur lindi Jesune virgjérisht, Nena e panjólshime, dhe Virgjéresha Hyjlíndese, ne Bethlehém ne grazhd, Birit i therriste: Bir' i dashur Zoti Krisht, habitem fort per keté cudí, Zot edhe Perendí, krijetar i gjithë bóteve, ben ç' te duash, te gjitha ne dor' i ke.

LAVDI, T. T. II. Profeti Daniél pareshikój, dhe parctregój qe do te lintnje prej Virgjéreshes, ti o Fjal' e Perendise, Shpëtimtari i shpërteve tona.

TANI. Shpelle pregatitu, se Virgjéresha vjen

per të lindur Krishtin. Barinjtë e presin me fyell,  
Maget i sjellin ar liván dhe zmirnë. Besnikë pri-  
teni, me bujë dhe me brohorí.

### PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Mágeve u-tregón, një shpelle yll' i ndriçim,  
edhe atá per Krishtin, dhurata po gatitin, florí  
dhe zmirnë dhe liván.

Zbrite në Bethlehém, siç thonë profetite, dhe  
derën e Parajsës, per njërczit e çele, o Zoti Krisht  
o Perendí.

Grazhdin bej-e gatí, o Shpell' e Bethlehemit,  
se Zot' i gjithësisë, mi ty perhapi rezet, per ndje-  
sen e mëkátave.

LAVDI DHE TANI. Ja Jesú Krishti vjen, o  
shpelle përgatitu, o Bethlehém gëzohu, se ti ke  
per të lindur, shpëtimin e besnikëve.

### NDËNJËSORE, T. I, TON TAFON SU

Mi dhënë Zoti zbret, që prej qellit të lartë, dhe  
vjen në Bethlehém, per të lindur në shpelle, prej  
Zonjës dhe Hyjlíndesës, Shen Marisë si çilimí,  
Zoti që i mpron, foshnjat dhe çiliminjtë; eni mbli-  
dhuni, me gas ta presim të gjithë, me zell dhe  
me drejtësi.

### LAVDI DHE TANI, gjithajó.

Gëzohu o Sión, Bethlehém përgatitu, se Krishti  
Perendí, yll të ndriçim nga lindja, dërgón dhe na  
lajmëron, që po zbret permi dhé per né. Gjithë  
Engjëjtë, edhe fuqitë qëllóre, shtangen se po

lint, prej Virgjereshes se Shenjte, shpetonjes i njéresve.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

## T. T. II, ANGELIKE DHINAMIS

Ja profetít' u-mbushne te gjitha ploterísht, se Krishti Perendí, neser ne shpellen lint, prej Nenes se bekuar qe po mbetet pas lindjes, Virgjéresh' e kulluar, dhe mblidhen gjithé Maget dhe po i sjellin florí, me fýejte po kendojne barinjte me ngazellím; o Shpetimtár o Jesú Krisht, nder dhe lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

## SHKURTORJA, T. I, TON TAFON SU

Gezohu Bethlehém, Efrathá pregatitu, se ja ku po te vjen, Virgjeresha e Shenjte, te lindre Barín' e Math, Shpetimtarin e grígjave; zbresin Engjëjte, dhe me barinjte kendojne, ty o Shen Marí, si Virgjereshe dhe Nene, o Zonje Hyjlíndese.

## SHTËPIA

Shoqeria e gjithé Aterve dhe Shenjtóreve, Abrahami dhe Isaaku dhe Jakobi, gezohen per lindjen e Shpetimtarit, edhe te lavderojne ty, o Shen Marí Virgjereshe, si Nene te Jesú Krishtit, dhe Zonje Hyjlíndese.

## SINAKSARI

Gjithe sot, te Dielen perpara Kershendéllave, kujtojme te gjithé Aterit e Shenjte qe prej Ada-

mit gjer në Shen Josefin, Vlesorin e Shen Marisë, ashtú sikunder nëmerohen në gjeneallogjinë historike të Ungjillorit Shen Luká; gjithashtú kujtojmë edhe Profetet edhe Profeteshat.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

### ZBRITESORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

*Kendohen Zbratesoret e para (A) të Kershendéllave:*

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítëni; ja Krishti mi dhënë ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, përhyrnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

III - A. Përpara nga jetet, lart në qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjreshës, si një foshnjë u-çfaqë, o Krisht Perendí të fálemi: Ti që na ngrite përpyetë me nder, o Zot i Shenjtë je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulëzuar prej Hyjlíndësës, prej mali hieplót, dhe të dendur me lisa, dhe umishcrovë prej Marisë, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Atë me hir, për shpëtimin e njëresve Ëngjellin, që paqen perëndore sjell, dërgovë përmi dhé; sot pra të udhëhequr me dritë Perëndie, që menatë ngríhemi, dhe lavderojmë njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, passi u-gelltít ne det, prej peshkut te math, doli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpëtimtár, shkoj nga gjir' i Virgjereshes dhe Hyjlíndeses, se u-misherua pa pesím, edhe Nenen e la te pacénshime.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne besemire, trimérisht perbuzne úrdherin e shtýpesit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí atëror, je i bekuar.

VIII - A. Furra veseplote na tregój nje shembell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnójm' e le t' i fálemi: E bekoni te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistér te çudicim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubík u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri até qe bota nuk e nxe, Krishtin Perendí; e madheshtojme pra me kenge sot.

## DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Patriket e Shkriptúrave, Steráterit e Ligjes, me besë ndritne posi yj, Abrahami i pari, Isaaku Jakobi, dhe te gjithë Profetet, shkelqyen posi díelli, si llambadhe te ndrícime lart ne qell, edhe tere boten e erresuar, e udhehoqne ne pendím, me mesime Profetesh.

Gezohu ti o Bethlehém, o Efrathá gatitu, se Virgjresha ja ku vjen, qe ta lindre ne shpellen, permi nje grazhd Jesú Krishtin; mblídhemi pra te gjithë, Stergjýsherit dhe Aterit, Abrahám Isaák dhe Jakobi tok, me Patriket Gngjajt' edhe Profetet, edhe me gas kremtojmë sot, vengjillen e shpetimit.

### LAVDERIMET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Zerin e ngrer Sión edhe thirr, qytét i shenjt' i Perendise edhe leçít, kujtimin e Abrahamit, me Isaák dhe Jakób, dhe nderoje ditën e Steráterve; se ja ku po mblídhemi, edhe ja ku gatítemi, ta madheshtojmë, Moisine Profétn' e Math, dhe Davidin Mbret, Samuelin dhe Jobin tok. Ejani qe te gjithë pra, ketú dhe hymnójeni, ditën e parc-kremtimit, edhe me besë kerkójini; Jesújt Perendise, qe tu fale njerzise, meshire dhe shpetím.

Eja o Shent Ellí o Profét, qe udhctove me nje qere te zjarrte lart, ne qellin perpara Zotit, me Elisheun taní, dhe me Ezekine ngazellóhuni; Profete te Shenjte, te frymesuar te Shkrónjave, per Kershendellat, e Jesújt vallezeni sot, dhe kendójeni ju o tuf' e te Dréjteve. Djema te lumc-rúarshem, te hedhur ne furr' e zjarr, qe shuat flagen me vesen, e Shpirtit Shenjt per né lútju-ni; Jesújt Perendise, qe tu fale njerzise, meshire dhe shpetím.

Ja ku u-çfaq mi dhene taní, sipas leçitjes, se

Proféteve fáqeza, Hyjlíndcsja Virgjereshe, qe lajmerój çdo Patrik, edhe çdo i Drejte i Shkriptúrave. Me ta vallezojne, edhe grat' e shkëlqýera, Sarra Rebeka, dhe Rakela me Annen tok, dhe e shoq' e drejt' e Moisi ligjevénésit; sot ngazellohen tok me to, dhe anet e bóteve, tere kriesa gezohet, se Perendia po zbret mi dhé; Jesúj Shpetimtari, qe tu fale njerezise, meshire dhe shpetim.

LAVDI, T. T. IV. Shoqeria e Proféteve te Ligjes, ungjillczój hirin e beses, me lindjen e Zotit Jesú Krisht, edhe e leçiti ne shpirtet e Ferrit, si Shpetimtár me anen e Ngjalljes; o Zot lavdí me ty.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Virgjereshe. Te hymnojme, se prej Birit qe linde, Ferri u-roberua, Adami u-nduall prape, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe né múarme jetë. Perandáj po hymnojme dhe therresim: I bekuar je, o Krisht Perendí, qe e pelqeve keshtú, lavdí me ty.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjeresha sot po vjen, ne Bethlehém per te lindur, Fjalën e perjétslime, brenda ne shpellen se fshehti. Vallezó, e tere bota dyke degjuar, lavderó, bashke me Engjajt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

### APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perendí i Aterve tanë. Se

na i bërë të gjitha me të drejtë.

Prej Letres së Palit për Hebrejtë.

Vellezer, Abrahami u-vendos me besë në dhënë e zotimit si në një tokë të huaj, edhe banonte në tenda me Isaakun dhe Jakobin, trashëgimtarët e perbashkme të gjithat zotimi, se priste qytetin, i cili do të themelohej prej kryemjështerit edhe ndertónjesit, i cili është vetë Perëndia. Edhe ç' t' ju them edhe? Se nuk kam kohë që tju tregoj për Gedeonin, Barakun, Samsonin, Iefthën, Davidin, Samuelin edhe Profetët, të cilët me anën e besës përmbysën mbretërit, vepëruan drejtësi, m'uarnë zotime, mbyllën gojë luanesh, shuan forcë zjarri, shpëtuan nga goja e shpatës, u-forcuan prej dobësisë, u-treguan të fortë në luftë, i çakërdisën ushtëritë e huaja. Gra pritën të vdekurit e tyre prej ngjalljes; të tjerë u-munduan dhe refuzuan çlirimin që të presin ngjallje më të mirë; të tjerë u-provuan me tallje dhe kamçike, me vargónj dhe me burgje; u-lapidian, u-sharruan, u-ngacën, u-therën me shpatë; shetitën me lëkurë delesh e dhish, të varferuar, të helmuar, të munduar (për të cilat nuk ishte e vyer bota), të arratisur në shkretëtirat edhe malet edhe shpellat edhe vrimat e dheut. Edhe këtë të gjithë, ndonëse deshmuan për besën, nuk e m'uarnë zotimin e Perëndisë, i cili parëshikoj një gjë më të mirë për në, që të mos perfektóheshin pa në. Përandaj, edhe në, dyke patur rotull një re t' atillë deshmorësh, le të hedhim tutje çdo barrë

dhe çdo mëkát, që na thur me lehtësi, dhe le të rendim në luftën, që kemi përpara, dyke shikuar Jesunë, kryetarin dhe mbarónjësën e besës.

## UNGJILLI PAS MATTHEUT

Libra e gjenealogjisë së Jesú Krishtit, të birit të Davidit, të birit të Abrahamit. Abrahami lindi Isaakun; dhe Isaaku lindi Jakobin; dhe Jakobi lindi Judën dhe të vellëzerit; edhe Juda lindi Faresin dhe Zarën prej Thamarës; dhe Faresi lindi Esromin; dhe Esromi lindi Aramin; dhe Arami lindi Aminadabin; dhe Aminadabi lindi Naasonin; dhe Naasoni lindi Salmonin; dhe Salmoni lindi Boozin prej Rakabës; dhe Boози lindi Obedin prej Ruthës; dhe Obedi lindi Jessën, dhe Jesseu lindi mbretin David. Edhe mbreti David lindi Solomonin prej së shoqes së Uriut; edhe Solomon lindi Roboamin; dhe Roboami lindi Abianë; dhe Abiáj lindi Asanë; dhe Asáj lindi Josafatin; dhe Josafati lindi Joramin; dhe Jorami lindi Ozinë; dhe Ozia lindi Joathamën; dhe Joathami lindi Akazin; dhe Akazi lindi Ezekinë; dhe Ezekia lindi Manasinë; dhe Manasiu lindi Amonin; dhe Amoni lindi Josinë; dhe Josia lindi Jekoninë dhe të vellëzerit në kohen e syrgjynosjes së Babillonës. Edhe pas syrgjynosjes së Babillonës, Jekonia lindi Sallathielin; dhe Sallathieli lindi Zorobabelin; dhe Zorobabeli lindi Abiudin; dhe Abiudi lindi Eliakimin; dhe Eliakimi lindi Azorin; dhe Azori lindi Sadokun; dhe Sadoku lindi Akimin; dhe

Akimi lindi Eliudin; dhe Eliudi lindi Eliazarin; dhe Eliazari lindi Matthanin; dhe Matthani lindi Jakobin; dhe Jakobi lindi Josefin, të shoqin e Marisë, prej së cilës lindi Jesú i quajtur Krisht.

Pra, të gjitha brezat që nga Abrahami dhe gjer me Davidin janë katërmbëdhjetë breza; dhe që nga Davidi gjer në syrgjynosjen e Babillonës janë katërmbëdhjetë breza; dhe që nga syrgjynosja e Babillonës gjer me Krishtin janë katërmbëdhjetë breza.

Edhe lindja e Jesú Krishtit ka ngjarë kështu: Passi u-vlua me Josefin Maria, e-jema, përpara se të bashkóheshin, mbeti me barrë prej Shpirtit të Shenjtë. Dhe Josefi, i shoqi, i cili ishte njeri i drejtë dhe nukë deshte ta difamonte, mejtotej ta ndante fshéhtazi. Po kur aý po mejtonte ketó, ja ku iu-fanés në endërr Gëgjelli i Zotit, edhe i tha: “Joséf, i bir i Davidit, mos kij frikë ta marresh grua Mariamen, se ajó mbeti me barrë prej Shpirtit të Shenjtë, dhe do të lindë një bir, edhe do tja quash emrin Jesú, se aý do ta shpetonjë pópullin nga mekatat. Edhe të gjitha ketó u-bënë që të mbushen fjalet e thena prej Zotit: Ja ku Virgjresha do të mbetet me barrë dhe do të lindë një bir, edhe do tja quash emrin Emanuél, domethënë: Perëndia është me né.” Edhe Josefi, pasi u-squa nga gjumi, bëri siç e urdheróje Gëgjelli i Zotit, dhe e mori gruan, edhe nuk e njohu gjer sa lindi të birin e parë, dhe ia quajti emrin Jesú.

19. *Bonifati, Dëshmori i Shenjtë.*

20. *Parëkremtja e Lindjes trupesore te Zotit tone Jesú Krisht; Ignati, Deshmori i Shenjte dhe hyjprures.*

### PERLGSHORJA E PARËKREMTES, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Pregatitu Bethlehém, se ja Parajsa na u-çel; zbukurohu Efrathá, se drur' i jetes lulezój, brenda ne shpellen prej Zonjes Virgjereshe. Parajse na u-çfaq, gjir' i ndriçim i saj, i shenjt' e shpirtëror, ku bim' e qíellit po mbin, se hame prej asáj dhe rrojme dhe nuke vdesim si Adami. Po lindet Krishti, dhe né te renet, do na ngrere per jete.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjeresha sot po vjen, ne Bethlehém per te lindur, Fjalën e perjëtshime, brenda ne shpellen se fshehti. Vallezó, e tere bota dyke degjuar, lavderó, bashke me Engjejt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

*Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 26 te Nentorit gjer me 24 te Dhjetorit. Pas kesáj date kendohet Shkurtorja e Kershendëllave.*

21. *Juliana, Deshmorja e Shenjte.*

22. *Shen Anastasia, Deshmorja e Madhe.*

### PERLGSHORJA E SHËN ANASTASISE, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me ze te math po te therrét: Dhenter ty te dësheronj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqësohem dhe varrosem tok me

Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te ggezohem tok me ty, edhe vdes per emrin tent, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me mua qe per ty sakrifikohem. Dëgjona lutjet, edhe shpetoji, shpirtet tona prej vdekjes.

23. *Shen Naumi.*

PERLCSHORJA E SHEN NAUMIT,  
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Nga bota u-hoqe krejt, pasove Krishtin me mall, u-zvordhe nga trupi yt, rrojte me shpirtin si Shenjt, Naúm i lumcrúarshim; rende si Apostujte, dhe leçite Ungjillin, ktheve ne besen tone, Makedonas pa numer, perpara Zotit ti nermjetó, ti na shpetó gjithenjë.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o Shen Naúm Ashketí, thesár dhe arke, e shkelqyer e vójtjeve, se Kryqin mi sup e ngrite, dhe Zotit Krisht pas i ré, dhe sakrifikove veten pa kursím; deshirat e póshtera, trupesore perdhé i shkel, dhe me virtuta, shpirtin tent e stolís e ngre, dhe me zell qellór si Parajsen e larteson. Pra sot ketú po mblídhemi, kremtojme kujtimin tent, o Shen Naúm i dëgjuar dhe te perlotur te lútemi; na mpro prane Zotit, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

Ndrit si thengjill i ndezur ne qell, i frymesuar si Profetet prej Shpirtit Shenjt, ne boten fitove fame, dhe predikove kudó, fjalet e Ungjillit plot me ngazellím; dhe driten qe s' perendon, e perhape kudó mi dhé, dhe shkretetiren, e vesove qe

lártazi, dhe thëngjijt' e saj i flladite çuditerisht. Pra kryetari Zoti Krisht, kuroren e mûndjeve, të ka dhuruar o Atë edhe Parajsen e Çngjējve; përpara tij mprona, dhe të gjithëve dhurona, meshirc dhe shpetim.

Shkallë që lart në qellin arrin, o At i Shenjtë, na u-çfaqë mi dhënë ti, u-ngrite përpara Zotit, dhe me Jesunë po flet, Oshenâr i lumur Ashketi me nam; dhe dritën e qiellit, dhe t' Ungjillit të Zotit Krisht, e predikove, nga tribunat e Kísheve, edhe njërczit i ndriçove me bes' e mall; pra në Parajsen je taní, dhe lutesh për gjithë né, që ta kremtojmë kujtimin përunjesisht dhe të lútemi; na mpro pranë Zotit, dhe të gjithëve dhurona, meshirc dhe shpetim.

LAVDI, T. II. O Shen Naúm me nam, virtuta ke lëruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtórcve.

TANI. Çdo shpresë me ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj përher' e ti me pro.

## PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Çfaqësh në vogelí, i zgjédhuri i Zotit, dhe en' e shenjteruar, o At i frymesuar, prej Krishtit dhe prej Shpirtit Shenjt.

Kryqin në dor' e mban, o Ashketi i lumur, dhe djajtë dhe demonet, fantazmat dhe kuçedrat, o At' i çkaterrove krejt.

Djajtë i shtype krejt, dhe faqebardhë dolle, me

Kryqin dhe me Krishtin, edhe u-lavdërove, o Atë Oshenár me nam.

LAVDI DHE TANI. Pate keq dashurí, për bukurít' e qellit, dhe gjárperin e shkele, dhe shkove në Parajsën, dhe lutesh gjithënjé për né.

#### NDËNJËSORE, T. I, TON TAFON SU

Jetove shpresërisht, përmi dhënë o Atë, i pastër dhe pa cen, si i zgjedhur i Zotit, si dritë udhëhëqëse, e të gjithë besnikëve, pra të lútemi, të nermjetósh pranë Krishtit, të shpëtóhemi, o Shen Naúm i degjuar, o Atë lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Si nënë të Jesújt, që të gjithë të njohim, o Zonjë Shen Marí, Virgjëreshë pas lindjes, përìkim pra me ty me mall, si e mirë që je për né; ty të kemi pra, né mëkatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpëtimtare në ngasjet, o Nënë Hyjlíndëse.

#### T. T. IV, TIN SOFIAN

More Kryqin e Zotit tonë Jesú, edhe pas e vazhdove gjer në mbarím, dhe prapë s' u-ktheve më, në qytetet e njëresve, me përmbajtje dhe vajtje, pësime të vravë krejt, dhe e bërë trupin tënt një tempull të Shpirtit Shenjt; more pra dhuratat, për mundimet e rënda, lengatat të na shërósh, dhe demonet të na i dbosh, o Naúm Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, të na dhuronjë ndjesën e mëkátave, neve që po e kremtojmë, bërërisht kujtimin tënt.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim te perunjur o Shen Marí, qe ne shqoten e jetes brenda ne det, po rrihet prej éreve, dhe perpiqet prej válave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újve, edhe ne funt te Ferrit, po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpctome dhe shpjerme shpejt, ne limán dhe ne qetcsí, se me besë po te therrés: Lutu-i Birit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave, se me ty kemi shprese, gjithë te pavýerit.

#### T. T. IV, TIN SOFIAN

Çdo te mire te jetes prapa e lé, edhe ndónese kishe trupin mi dhé, u-bere si Engjejte, edhe rronje ne qiellin; se per çudí i shove, pesimet e trupit tent, edhe shok i Trinise, u-çfaqe me lumerí; pra sherón semundjet, dhe lengatat e trupit, dhe dbon çdo demón te lik, me nje fjal' e nje porrosí, o Shen Naúm Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe po e kremtojme, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Ti o porte qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjte plot me shkelqím, o re udhéhéqese, ti o shkalla e qëllshime, ti o Parájs' e méndeshme, per Even shpctónjese, ti o thesár i botes, i shtrenjte i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjte, ti shpetimin na solle, nga fajet e prínderve, dhe mallkimet e gjýshcrve. Perandáj te therrsim: Nermjetó prane Birit tent, te na dhuronje

ndjesen e mëkátave, neve që sot e kremtojmë, besërisht kujtimin tent.

### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojne, po ti përkrah-më dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpërohëni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetëlindje.

PARËVARGU. Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit.

### UNGJILLI I MËNGJËZIT PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishëpujve: Të gjitha më i ka dorëzuar im-Atë; dhe asnjë nuk e njeh Birin përveç Atit; edhe asnjë nuk e njeh Atin përveç Birit edhe atë, të cilit Biri do tja zbulonjë. E jani tek unë të gjithë të lódhurit edhe të ngarkúarit, edhe unë do tju përë. Ngrëreni zgjedhën time më veten tuaj, dhe mësoni prej meje që jam i butë dhe i perunjur nga zemra, dhe do të gjëni përë në shpirtin. Se zgjedha ime është e lehtë.

*Psalmi 51 pa zë.*

LAVDI. Me nermjetimet e Oshenarit, o mëshirëplót, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

O Shen Naúm me nam, virtuta ke lervuar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

### SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Prej foshnjerise, u-blatove si kurbán me mall, dhe me virtutat, shkrepctive Shen Naúm me nam, per até qe te bekój perpara se te lintnje. Dhe u-çfaqe, si i par' i Oshenárove, dhe si kollonizatór i shkretetírave; te therrés pra sot: Lum ti o Ashketí i Math.

### SHTGPIA

Desherove urtesine qe prej foshnjerise, o Naúm At' i Shenjte Oshenár, dhe u-ndave prej botes dhe u-ngjite ne qell, ku fitove kuroren e pafishkur te Oshenárove, dhe u-lavderove prej Krishtit ne Parajsen e Shenjtóreve. Perandáj, pra, te therrsim sot: Lum' ti o Ashketí i Math.

### SINAKSARI

Me njezét e tri te ketí múaji, kujtojme Shen Naumin e Ohrise, Atin tone Oshenár.

Gjithe sot, kujtojme te Dhjete Deshmoret, qe deshmuan ne Krete.

Gjithe sot, kujtojme Shen Palin, Atin tone Oshenár, kryepeshkopin e Neokesarise, nje prej te

treqint e tetëmbëdhjetë Aterve të Shenjtë të Sinodit të Nikesë.

Gjithë sot, kujtojmë dedikaten e Kishës së Madhe së Perëndisë.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndi, meshirona. Amin.

## ZBRITËSORET, T. I, KHRISTOS JENNATE

*Kendohen Zbritesoret e para (A) të Kershëndëllave:*

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítëni; ja Krishti mi dhënë ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdi.

III - A. Perpara nga jetët, lart në qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjëreshës, si një foshnjë u-çfaqë, o Krisht Perëndi të fálëmi: Ti që na ngrite perpjete me nder, o Zot i Shenjtë je.

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule prej asáj o Krisht, ke lulezuar prej Hyjlíndesës, prej mali hieplót, dhe të dendur me lisa, dhe umishërove prej Marisë, dhe linde o Perëndi: Zoti i fuqishim lavdi me ty.

V - A. O Zoti i paqes, o Atë me hir, për shpëtimin e njëresve Engjellin, që paqen perëndore sjell, dërgove përmi dhé; sot pra të udhëhequr me dritë Perëndie, që menatë ngríhemi, dhe lavderojmë njeridáshesin.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, pasi u-gëlltít

ne det, prej peshkut te math, doli dhe nuk u-nga, gjithashtu tani, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpëtimtar, shkoj nga gjir' i Virgjreshes dhe Hyjlindeses, se u-mishërua pa pesim, edhe Nenen e la te pacënshime.

VII - A. Tre Djemat që u-rritne besmire, trimërisht perbuzne úrdherin e shtëpsit, nga furra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perëndi atëror, je i bekuar.

VIII - A. Furra veseplote na tregój nje shembell, te çudise që shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat që priti; ashtu dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjreshen aspák. Pra le ta hymnojme e le t' i fálemi: E bekonit te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartësoni permi te gjitha jetet.

IX - A. Mistër te çudiçim, shikónj dhe s' e marr dot vesh; se si qell nje shpelle ndrit; fron Kerubik u-çfaq Virgjresha; dhe grazhdi i vogel, e nxuri atë që bota nuk e nxe, Krishtin Perëndi; e madheshtojme pra me kenge sot.

### DERGIMESORET, T. III, FOS ANALIOTON

O shkretëti e gezohu, dhe lulezó si zambaku, se t' i ka shtuar pallatet, dhe bijt' e tu Shen Nami, dhe ti o reth i Ohrise, këcé dhe ngazellohu, ne ditën e sotme.

Ti o kështjell' e florinjte, me dymbëdhjete fortesa, o fron që ndrit posi dielli, ku Mbreti rri me

Shenjtoret, ti o çudí qe s' ke kufí, o Nene Virgjereshe, qe Zotin na linde.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Ti qe perbuze te mirat e ketí shékulli, dhe pate mall per qellin, edhe per shkretetiren, o Ate Shen Naúm te gjithë na fton, ta kremtojme kujtimin tent, se pranc Zotit perhere po nermjetón, per shpctimin e besníkeve.

Ne botë s' deshe gjë tjater pervéc virtútave, me to e lavderove, permi dhene sa rrojte, Jesune Shpctimtarin me ngazellím, dhe fitove lavdí ne qell, edhe sherime lengatash po na burón, Shen Naúm Oshenár me nam.

I mir' i matur i bute edhe i embel fort, ke qen' o At i Shenjte, permi çdo njerí tjater, dhe tempull shpirtëror i Zotit Jesú, u-tregove ketú mi dhé, edhe dhurata sherónjese po u fal, pasurísht adhurónjesve.

LAVDI, T. II, O Shen Naúm me nam, ne boten u-degjove, demonet i dermove, dhe Çngjejt' i arrive, dhe shpirtet tona i shpctón.

TANI. Zonje Hyjlíndese, me lutje pranc Birit, çlirona nga mekatat, shpetona dhe dhurona, Parajsën e Shenjtórcve.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjresha sot po vjen, ne Bethlehém per te lindur, Fjalën e perjëtshime, brenda ne shpellen se fshehti. Vallezó, e tere bota dyke degjuar, lav-

deró, bashke me Engjajt' e me Barinjte, Perendín' e ameshuar, qe desh te çfaqet, si djal' i ri permi dhé.

## APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit është e nderuar perpara Zotit. Si do tja çpagúajme Zotit te gjitha te mirat?

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezer, bindjuni krérove tuaj, dhe degjójini; se atá vigjellojne per shpirtet túaja, meqéneqë do te japin fjale per keté gje; se atehere do ta bejne me gezim dhe jo dyke psherctitur; edhe kjo nuk është e dobishme per ju. Fáluni per né, se jemi te bindur qe kemi ndergjéggjie te kthjelllet, se jemi perpjekur te sillemi mire me te gjithethe; dhe mé teper ju lutem ta beni keté gje, qe te vendosem mé shpejt prane jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti se vdékuresh barine e math te dhenve, Zotin tone Jesú, me gjakun e dhjates se perjetme, ju stervitte per çdo veper te mire, qe ta mbaroni deshiren e tij, dhe ju befte si ta gjenje te pelqyer me anen e Jesú Krishtit, i cili paste lavdí ne jetet e jéteve. Amín.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohe, Jesúj qendrój ne nje fushe me grupin e Dishépujve dhe me nje shumice te madhe prej pópulli nga e tere Judea dhe nga Jerusalemi dhe nga anedeti i Tyres edhe Sidones, te

cilet kishin ardhur qe ta degjonin dhe te sheróheshin prej semúndjeve dhe demónëve, edhe béheshin te shendoshe. Dhe pópulli i tere deshnin ta preknin; se nje force dilte prej atí, edhe i sheronte te gjithë. Dhe Jesúj i ngriti syte mi Dishépujte, dhe u tha: “Lum’ ju te várferit, se Mbretëria e Perendise eshte júaja; lum’ ju qe jini taní te uret, se do te ngínjeni; lum’ ju qe qani taní, se do te qeshni; lum’ ju, kur njërczit do tju urrejne, dhe do tju çkisherojne, dhe do tju perqeshin, dhe do tjua nxijne emrin per te Birin e njeriut. Gezóhuni até dite, dhe ngazellóhuni, se roga juaj do te jete e madhe ne qell.”

### KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

24. *Vengjilla e Kershendéllave. Shen Evgjenia.*

### PERLËSHORJA E VENGGJILLES, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shen Maria shkruhej sot, bashke me plakun Shen Joséf, si prej gjaku Davidík, ne Bethlehém dhe ne Judé, ku shkoj te linde Jesune Shpetimtarin tone; kerkonin pra kudó, vent ku te shtróheshin; dhe nuke gjenin vent, te flinin asgjekúnt; pastáj e gjetne shpellen ku u-shtrua Mbretëresha si ne pallát. Po lindet Krishti, dhe né te renet, do na ngrere per jete.

### PERLËSHORJA E SHEN EVGJENISE, T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerisht, u-tregove shembell e Zotit,

se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesim, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Ɖngjëjtc, o Evgjení e Shenjtë lavdí me ty.

25. *Kershendellat.*

PERLGSHORJA E KERSHENDELLAVE, T. IV.

Lindja jote o Krisht Perëndí dhe Zot, i lindi botes driten e dijes se hýjeshme; se atá që adhuronin çdo yll në qell, si sot prej yllit po mesóheshin, ty t' adhurojne Díellin e drejtesisë, dhe të të njohim si Lindjen që lártazi, o Zot lavdí me ty.

## SHËRBESA E MBREMSORES DHE MESA E SHËN BASILIT

*Me 24 të Dhjetorit në mëngjës, pas Oreve të Medha, këndohet Mbremesorja e Kershendëllave dhe pastáj behet Mesha e Shën Basilít me régullen pasónjese: Passi bekón Prifti, këndohet Psalmi Nistór; pastáj Prifti thote Litanine e Madhe; pastáj këndohen Thirrtoret; pas Lavdise behet Hyrja e Vogel; pas Hyrjes dhe Profetive, këndohet menjehere Apostulli, dhe pastáj vazhdón regullisht Mesha e Shën Basilít të Math që nga Urata e Apostullit edhe tutje.*

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Mágeve u tregón, një shpelle yll' i ndriçim, e-dhe atá për Krishtin, dhurata po gatitin, florí dhe zmirne dhe liván.

Zbrite në Bethlehém, siç thone profetite, dhe

deren e Parajsës, për njërczit e çele, o Zoti Krisht o Perendí.

Grazhdin bej-e gatí, o shpell' e Bethleheimit, se Zot' i gjithësisë, mi ty përhapí rezet, për ndjesën e mekátave.

Ja Jesú Krishti vjen, o shpelle përgatitu, o Bethlehém gezohu, se ti ke për të lindur, shpëtimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Një mbreterí mi dhé, një Perendí në qellin, gezuan gjithë kombet, në kohën e Augustit, lavdí me ty o Zoti Krisht.

### APOSTULLI

Zoti me tha: Ti je im-Bir, unë të kam lindur sot. Lyp-me, dhe do të jap kombet për trashëgim.

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Perendia, pasi u foli qemoti Aterve tanc me anën e Profëteve në shumë vise dhe me shumë mënyra, na foli edhe neve në ditët e fundme me anën e të Birit; të cilin e ka emëruar trashëgimtar për të gjitha, dhe me anën e të cilit i ka bërë jetët; i cili ishte shkelqimi i lavdisë tij edhe yrneku i personës tij, edhe me fjalën edhe me fuqinë e vetë na spastróji mekátat, edhe ndenji me të djathten e madhështisë me të lartat; edhe u-bemé i math se Engjëjste sipas emrit të ndryshme, që kishte trashëguar. Se cilit prej Engjëjve i ka thënë nonjë herë, "Ti je im-Bir, unë të kam lindur sot?" Edhe perserí thote: "Unë do të jem Ati, dhe aý do të jete im Bir." Pastáj perserí, kur e siell të

Birin ne bote, thote: “Edhe do ta adhurojne te gjithë Engjejt’ e Perendise.” Edhe per Engjejte thote: “Frymat jane Engjejt’ e tu, flaga dhe zjarrri jane sherbetoret e tu.” Po per Birin thote: “Froni yt, o Perendí, qendrón per jete; shkopi i Mbretcrise sate shkopi i drejtesise. E deshe drejtesine, dhe e urreve padrejtesine; perandáj te ka lyer Perendia, Perendia yt, me vajin e ngazellimit permi shoket e tu. Edhe ti, o Zot, ne krye e themelove dhene, dhe e ke bere qellin me dúart’ e veta. Ató do te humbasin, po ti do te mbetesh; edhe te gjitha do te vjetrohen si nje robe, dhe do te peshtillen edhe do te ndrohen si nje teshe, po ti do te mbetesh gjithaý, edhe vjetet e tu nuke do te kenë mbarím.” Apo cilit prej Engjejve i ka thene nonjhere, “Rri me te djathten time gjer sa te t’ i shtronj armiqtë nene kembet?” Apo nuke jane qe te gjithë Engjejte meshetare shpirtorë, qe dergohen tu sherbejne atyre, te cilet do ta trashegojne shpetimin? Perandáj duhet t’i veme re mé teper ató, qe kemi degjuar, qe te mos shkasim. Se neqóftese esht e vertete fjala, e folur prej Engjejve, qe çdo çbaritje dhe çdegjím denohet sipas se drejtes, valle si do te shpetojme né, qe kemi plogruar shpetimin e math, te cilin na e leçiti Zoti, dhe na e vertetuan atá, qe e kane degjuar.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M’ ató dite, dolli nje dekrét prej Kesár Augus-

tit për të regjistruar tërë botën. Kjo regjistratë ishte e para, që u bë, kur ishte Kirini guvernor i Sirisë. Dhe të gjithë shkonin edhe regjistroheshin, cilidó në qytetin e vetë. Pra, edhe Josefi prej qytetit Nazarét të Galileës shkoj në Judé, në qytetin e Davidit, i cili quhet Bethlehém, nga që ishte prej shtëpisë dhe farefisit të Davidit, që të regjistroheshin me Mariamen, të shoqen, me të cilën ishte vluar dhe e cila ishte me barrë. Dhe kur ndódheshin atjé, rastisi t' i mbushen ditët për të lindur. Dhe e lindi Birin e saj të parë, dhe e peshollti me shpërgínj, dhe e vuri në një grazhd, se nukë kishin gjetur vent në gostéll. Edhe n' até vent ishin ca barínj, të cilët rúanin kopetë në kullotat. Edhe ja ku Engjelli i Zotit u vajti, dhe lavdia e Zotit u ndriti reth e rotull, edhe u-trempné fort. Edhe Engjelli u tha: "Mos kini frikë, se ja ku ju lajmerónj një gas të math për tërë pópullin, se sot ju ka lindur Shpëtimtari Zoti Krisht në qytetin e Davidit. Edhe kjo le të jetë shenja juaj: Do të gjeni një foshnjë të pesh-tjellur me shpërgínj edhe të dërgjur në një grazhd." Dhe befás një ushterí e madhe qëllorë u-bashkuan me Engjellin, dhe e lavderonin Perëndinë, dhe thoshnin: "Lavdí Perëndisë me të lartat, edhe mi dhënë paqë, dhe nër njërezit mirëdashje." Dhe pasi shkuan Engjijtë në qell, barínjtë thanë me njëri-tjetrin: "Le të shkojmë gjer në Bethlehém, dhe le ta shikojmë këtë punë, që ka ngjarë, të cilën na e dëftëu Zoti. Dhe vajtin

me nxitím, dhe e gjetne Mariamen dhe Josefin edhe foshnjen, te dergjur ne grazhd. Edhe kur e pane, treguan fjalet, qe u kishte thene Engjelli per keté djale. Dhe te gjithë atá, qe i degjuan, u çuditne per fjalet, qe u ishin thene barinjve. Dhe Mariama i rúante te gjitha ketó fjale, dhe i mejtonte ne zemër. Dhe barinjte u-kthyen, dyke lavderuar dhe dyke brohoritur Perendine per te gjitha ató, qe degjuan edhe pane, sikunder u ishte folur.

## SHËRBESA E MËNGJËZIT DHE MËSHA E SHËN JOAN GOJARTIT

NDËNJËSORET, T. IV, KATEPELLAJI IOSIF

Eni shihni beserísht, ku është lindur Zoti Krisht; le t' i biem gjithë pas, atjé ku ylli udhetón, bashke me Maget mbréterit e lindjes. Engjejte me mall, po e hymnojne pa pushím, barinjte plot me gas, u bien fýejve, dhe lavderojne te lindurin ne shpelle prej Kryezonjes, dhe Virgjreshes, ne Bethlehém te Judese.

Pse çuditesh Mariám, permi çudine qe te ngjan? Perendine qe s' ka mot, brënda ne mot e linda sot, dhe nuk e mora vesh keté ngjarje per-gjigjet. Burrë nuke kam, edhe nje bir si do te lint? Bir te lindur virgjerísht, cili ka pare gjer tani? Po kur dó Zoti ligjat e natyres permbysen. Na lindi Krishti, prej Virgjreshes, ne Bethlehém te Judese.

I panxeni Perendí, si na u-nxu ne gji taní? Birin Zotin pa kufí, si e mban Nena ne peqí? Pa fjal' e deshi vete dhe ashtú e bcri. Se nuke kishte trup, dhe mori trup vullnetarisht, edhe u-be aý qe ish si nuke ish per boten; me dy natyra, na lindi Krishti, qe t' i shpetonje njerezit.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohej ne paqesi, dhe ndriçohet prej njcsise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARGU. Prej gjirit te kam lindur perpara Driteprúrcsit; Zoti u-betua dhe nuke do pendohet.

#### UNGGJILLI I MËNGJJEZIT PAS MATTHEUT

Edhe lindja e Jesú Krishtit ka ngjare keshtú: Passsi u-vlua me Josefin Maria, e-jema, perpara se te bashkóheshin, mbeti me barre prej Shpirtit te Shenjte. Dhe Josefi, i shoqi, i cili ishte njeri i drejte dhe nuke deshte ta difamonte, mejtohej ta ndante fshéhtazi. Po kur aý po mejtonte ketó, ja ku iu-fanés ne enderr Ungjelli i Zotit, edhe i

tha: "Joséf, i bir i Davidit, mos kij frike ta marrësh grua Mariamen, se ajó mbeti me barre prej Shpirtit të Shenjtë, dhe do të lindë një bir, edhe do tja quash emrin Jesú, se aý do ta shpetonjë pópullin nga mekakat. Edhe të gjitha ketó u-benë që të mbushen fjalët e thena prej Zotit: Ja ku Virgjërësha do të mbetet me barre, dhe do të lindë një bir, edhe do tja quash emrin Emanuél, domethënë: Perendia është me né." Edhe Josefi, pasi u-squa nga gjumi, bëri siç e urdhërojngjëlli i Zotit, edhe e mori gruan, edhe nuk e njohu, gjer sa lindi të birin e parë, dhe ia quajti emrin Jesú.

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI. Të gjitha u-mbushnë sot me gas, se Krishti lindi prej Virgjërëshes.

TANI, *gjithajó.*

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesit' e mia.*

T. T. II. Lavdí Perendisë me të lartat, edhe mi dhënë paqë. Sot Bethlehemi pret atë, që rri mi të djathten e Atit. Sot Gngjëjtë e lavdërojnë foshnjën që lindi: Lavdí Perendisë me të lartat, edhe mi dhënë paqë, dhe nër njërezit miredashje.

ZBRITËSORE DYPLIKE, T. I,  
KHRISTOS JENATE dhe ESOSE LAON

*Nga ketó të dyja Zbritesore, të parat, të markuara me letren A, këndohen që me 21 të Nentorit gjer me 24 të Dhjetorit; të dytat, të markuara me letren B, këndohen që me 26 gjer me 31 të Dhjetorit; që të dyja tok këndohen vetëm ditën e Kershëndëllave.*

I - A. Ja Krishti lint lavderójeni; ja Krisht' i qellit vjen dilni prítieni; ja Krishti mi dhenc ngréhuni; Zotin pra e kendoni lart e mi dhé, dhe me ngazellime, perhymnójeni me mall, popuj dhe me lavdí.

I - B. Pópullin shpctój me çudí Krijetari  
 Qemoti kur e teri detin nje here.  
 Dhe taní qe lindi prej nje Virgjereshe  
 Na tregój Parajscn pra e lavderojme  
 Si njerí edhe si Perendí me kenge.

III - A. Perpara nga jetet, lart ne qell, ti ke lindur prej Atit si Bir, edhe taní prej Virgjreshes, si nje foshnje u-çfaqë, o Krisht Perendí te fálemi: Ti qe na ngrite perpjete me nder, o Zot i Shenjte je.

III - B. Verna veshin kur kendójm' o mireberes,  
 Unj-e ballen kryelárt' e te paudhit,  
 Ngrerna lart permi mekatin e mallkuar,  
 Bena te patundur me fuqine tende  
 Né qe te hymnojme beserisht me kenge.

*Pastáj kendohet pa ze:*

HIPAKOJA. Qelli ta pruri kulloshtren e kóm-beve, kur dérgjeshe ne grazhdin si foshnje, se Maget arthne me yllin, dhe u-çuditne jo nga kuroret edhe nga fronet po nga varferia. Se ç' eshte mé e varfer se shpella, dhe ç' eshte mé e unjur se shpárgeri? Po me ató ndriti pasuria e Hynise sate. O Zot, lavdí me ty.

*Pastáj vazhdojne Zbritesoret:*

IV - A. Shkop nga renja e Jesseut je, dhe lule

prej asáj o Krisht, ke lulczuar prej Hyjlíndeses, prej mali hieplót, dhe te dendur me lisa, dhe u-mishcrove prej Marisc, dhe linde o Perendí: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

IV - B. Abakumi parelajmcrój qcmoti  
 Pcr lindjen njerczore prej Shpetimtarit,  
 Se u-vlercsua ta pareshikonte,  
 Dhe me te vertét' i Bir' i Virgjreshes  
 E ndriçój dhe e perlindi njerczinc.

V - A. O Zoti i paqes, o Ate me hir, per shpetimin e njérsve Cngjellin, qc paqen perendore sjell, dergove permi dhé; sot pra te udhchequr me drite Perendie, qc menate ngríhemi, dhe lavderojme njeridáshesin.

V - B. Falna ndjese per lajthimet dhe mekatat  
 Neve qc po te kendojme qc menate,  
 Dhe shpetona o Jesú o mireberes  
 Dhe ndriçona per te gjetur udhen tone  
 Per te trasheguar lumerín' e qellit.

VI - A. Si Profeti Shen Joná, passi u-gelltít ne det, prej peshkut te math, dolli dhe nuk u-nga, gjithashtú taní, edhe Fjala e qellit Jesúj Shpetimtar, shkoj nga gjir' i Virgjreshes dhe Hyjlíndeses, se u-misherua pa pesím, edhe Nenen e la te pacénshime.

VI - B. Thelle Shen Jonáj ner újcrat e detit,  
 Nuke dilte per te qetesuar shqoten.  
 I plagosur nga shigjetat e armikut,  
 Zoti Krisht te lutem mprome nga reziket.

## SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

*Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 25 gjer me 30 te Dhjetorit.*

Virgjeresha lindi sot, te permiqénshimen Fjale, edhe dheu i blatón te paafrúarit shpellen; Engjjet, me Barinjte po lavderojne; Maget pra, bashke me yllin po udhetojne; se per né ka lindur Krishti, si djale foshnje, i parejéteshmi Zot.

## SHTËPIA

Bethlehem e çeli Edenin, éjani ta shikojme; e gjetme thesarin e fshehur, éjani t' i gezojme te mirat e Parajscs brenda ne shpelle: Atjé ka mbire rrenja e pavaditur, qe na fali ndjescn e mekátave; atjé u-zbulua pusi i pamihur, prej te cilit Profeti Davíd kerkonte te pinte uje; atjé Virgjeresha lindi nje foshnje, dhe ua shoj etjen Adamit edhe Davidit me ujen e jetes se pasosur. Perandáj le te vemi shpejt atjé, ku lindi Krishti, si djale foshnje, i parejéteshmi Zot.

## SINAKSARI

Me njezét e pese te keti múaji, kujtojme Lindjen mishore te Zotit edhe Perendise dhe Shpëtimtarit tone Jesú Krisht.

Gjithe sot, kujtojme adhurimin e Mágeve.

Gjithe sot, kujtojme Barinjte, qe e pane Zotin.

Paste lavdí ne jetet e jéteve. Amín.

VII - A. Tre Djemat qe u-rritne besemire, trimérisht perbuzne úrdherin e shtýpesit, nga fu-

rra dhe zjarri nuk u-trempn' aspák, po ne flage dhe ne prush, me kenge fáleshin: O Perendí atë-rór, je i bekuar.

VII - B. Djemat besmire nuk u-frikesuan,  
Po nga mall' i Perendise Mbretit tone  
E perbuzne úrdherin e nje tirani,  
Dhe ne mes te flages i kendonin  
hymne:

I bekuar je o Zot i gjithesisë.

VIII - A. Furra vesçplote na tregó j nje shembell, te çudise qe shkeli natyren, se ajó s' i dogji Tre Djemat qe priti; ashtú dhe zjarri i qellit s' e ngau Virgjereshen aspák. Pra le ta hymnó jm' e le t' i fálemi: E bekoni te gjithë Zotin me ze te math, dhe e lartësoni permi te gjitha jetet.

VIII - B. Djemt' e vjeter qe prej zjarrit nuk u-  
doqne  
Korezuan sheshit lindjen virgjërore  
Te pangár' e te padjegur te Marise.  
Zotin qe ka bere ketó çudira  
Me mirenjohje pópujt' e lavderojne.

MADHÇSHTIMET, T. I.

O shpirt madheshtoje, Marine e nderuar, dhe te lavderuar mi forcat Çngjellore.

O shpirt madheshtoje, Krishtin edhe Zotin, qe lindi ne nje shpelle, prej Nenes Virgjëreshë.

O shpirt madheshtoje, Zotin edhe Mbretin, qe u-adhurua prej Mágeve te Lindjes.

Maget dhe Barinjte, arthne t' adhurojne, Kri-

shtin që na lindi, në Bethlehém në shpellë.

Lindi Virgjërësha, Krishtin edhe Zotin, bren-  
da në një shpellë.

Pas sot Barinjte, Zotin të pështjellur, si fosh-  
një në një shpellë.

Bota sot gëzohet, se Krishti na ka lindur, prej  
Nenes Virgjërëshe.

Ëngjëjte nga qelli, lajm' i japin botes, që lindi  
Shpëtimtari.

LAVDI. O shpirt madhështojë, Zotin Perëndi-  
ne, Trinín' e lavdëruar, të Shenjt' e të pandarë.

TANI. O shpirt madhështojë, Marinë Virgje-  
reshen, që lindi Shpëtimtarin, dhe na çlirój nga  
Ferri.

IX - A. Mistër të çudiçim, shikónj dhe s' e  
marr dot vesh; se si qell një shpellë ndrit; fron  
Kerubík u-çfaq Virgjërësha; dhe grazhdi i vo-  
gel, e nxuri atë që bota nuk e nxe, Krishtin Pe-  
rendí; e madhështojmë pra me kengë sot.

IX - B. Heshtja është sot m' e lehtë dhe pa frikë;  
Kemi shumë mall po është shumë' e rende  
T' endim lavdërim për ty o Virgjërëshe;  
Po ndriçona dhe sipas dëshires sonë  
Falna dhe fuqí o Nen' e Shpëtimtarit.

### DERGIMSORJA, T. III, EPESKEPSATO

Na veshtrój që lartazi, nga qelli Shpëtimtari  
Krisht, lindja e lindjeve u-çfaq, dhe né të vërbe-  
rit në pus, pame të drejten fáqëza, se ja prej Vir-  
gjerëshes, na lindi i Madhi Zot.

## LAVDGRIMET, T. IV.

Defreni o te drejte, ngazellohu o qíell, keceni o male, se lindi Krishti. Virgjeresha rri si nje Engjell, dhe mban ne peqí Perendine e misheruar. Barinjte e lavderojne, Maget i blatojne dhurata, Engjejte e perhymnojne dhe thone: Zot i çudiçim lavdí me ty.

Ati e gjeti te pelqyer, Fjala u-misherua, Virgjeresha lindi, Perendine qe u-be njerí. Ylli e lajmerón, Maget e adhurojne, Barinjte çuditën, edhe kriesa ngazellohet.

O Virgjereshe Hyjlíndese, qe linde Shpetimtarin, dhe permbyse mallkimin e Eves. Pra te lavderojme me bese, dhe therresim dhe thomi: O Zot i çudiçim lavdí me ty.

Ejani ta perhymnojme, Nenen e Shpetimtarit, Virgjreshen e pacinuar. Gezohu o pallát i Krishtit, i Perendise dhe i Mbretit. Nermjetó perpara Birit, per shpetimin e besníkeve.

LAVDI, T. T. II. Kur arriu koha e ardhjes sate mi dhé, u-be registrata e besníkeve te tu, pas dekretit te Kesarit, se nisi Mbreteria jote e pafuntme. Perandáj te blatojme si vergjí, pasurit' e theollogjise Orthodokse, o Perendí dhe Shpetimtár i shpírteve tona.

TANI, T. II. Sot Krishti lint ne Bethlehém prej Virgjreshes. Sot i panísuri nis dhe Fjala misherohet. Forcat Engjellore ngazellohen, edhe i tere dheu gezohet me njërezit. Maget i blatojne dhu-

rata, Barinjte e leçitin çudine, dhe né po therresim pa pushím: Lavdí Perëndise me te lartat, edhe mi dhene paqe, dhe ner njërczit miredashje.

## HYRTORJA

Prej gjirit te kam lindur perpara Driteprúresit. Zoti u-betua dhe nuk do pendohet. Ti je prift i perjetme, pas úrdherit te Melkishedekut. Shpëtona o i Bir' i Perendise, qe linde prej Virgjereshes, né qe te kendojme Alilluia.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

Virgjeresha lindi sot, te permiqénshimen Fjale, edhe dheu i blatón te paafrúarit shpellen; Çngjçjte, me Barinjte po lavderojne; Maget pra, bashke me yllin po udhetojne; se per né ka lindur Krishti, si djale foshnje, i parejetshimi Zot.

*Ne vent te Hymnit Trishenjtór kendohet:*

Sa u-pagezuat me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht, Alilluia.

## APOSTULLI

Adhurójeni dhe lavdcrójeni Zotin ne tere dhene. Brohoríteni ne tere boten.

Prej Letres se Palit per Gallatianet.

Vellezer, kur u-plotesua koha, Perendia dergój te Birin, te lindur prej nje grúaje, te bindur nene ligjen, qe t' i çperblenje atá, qe ishin nene ligjen, dhe te marrim adoptimin si bij te Perendise. Dhe meqéneqe jini bij te tij, Perendia ju dergój Shpir-

tin e të Birit, që therrët në zemrat tujaja: Abbá, o Atë. Pra nukë je më shërbetór i tij, po bir i tij; edhe posa je bir, je edhe trashëgimtár i Perëndisë me anën e Jesú Krishtit.

## UNGGJILLI PAS MATTHEUT

Kur liri di Jesú në Bethlehém të Judesë, në ditët e Mbretit Heród, ja ku arthnë Magët prej lindjes në Jerusalém, edhe pyesnin: “Ku është Mbreti i Judenjve, që ka lindur? Se ja ku e pamë yllin në lindje, dhe arthnë t’i fálëmi.” Dhe kur i degjój këto fjale, Mbreti Heród u-trubullua bashkë me tërë Jerusalemin. Dhe i mbledhi të gjithë kryepfisterinjtë dhe shkronjesit e popullit, edhe i pyeste se ku ka për të lindur Krishti. Dhe atá iu-përgjeyne: “Në Bethlehém të Judesë, se kështú është shkruar prej Profetit: Dhe ti Bethlehém, dheu i Judesë, nukë je më i vogeli midis princërve të Judesë, se prej teje do të dalë një kryetár i cili do të qeverisë popullin tim Israél.” Atëherë Herodi i thirri fshëhtazi Magët, edhe i pyeti hollësisht për kohën kur ishte dukur ylli. Dhe i dërgój në Bethlehém, edhe u tha: “Ecceni, dhe kerkójeni djalin me kujdës, edhe kur ta gjeni, lajmërómeni, që të vinj edhe unë t’i falem.” Dhe atá, si i degjuan këto fjale të mbretit, u-nisnë, dhe ja ku ylli, që kishin parë në lindjen, u shkante përpara gjer sa arriu, dhe qëndrój mun atjé sipër, ku ishte djali. Dhe Magët, kur e panë yllin, u-gë-

zuan fort. Edhe si hynë në shtëpi, e gjetne djalin me Marinë, t' emën; edhe ranc, dhe iu-falën; dhe hapën thesaret, edhe i blatuan dhurata, ar dhe livan dhe zmirnë. Dhe të lajmeruar në enderr të mos kthehen tek Herodi, shkuan në vendin e vetë nga një udhë tjetër.

### MADHËSHTIMI I MESHËS, T. I.

Heshtja është sot m' e lehtë dhe pa frikë,  
Kemi shumë mall po është shumë e rëndë  
T' endim lavderim për ty o Virgjëreshë;  
Po ndriçona dhe sipas dëshirës sonë  
Falna dhe fuqi o Nën' e Shpëtimtarit.

### KUNGATORJA

Zoti i dërgoj shpëtimin popullit.

26. *Mbledhja e Shen Marisë; Efthimi, Hierodëshmori i Shenjtes, peshkopi i Sardes.*

*Perleshore dhe Shkurtore e Kërshëndëllave. Në rente kjo ditë të Dielen, kujtojmë Hyjprinderit, Shen Josefin, Vlesorin e Virgjëreshës; Davidin, Profetin dhe Mbretnin; dhe Shen Jakobin, të Vellan' e Krishtit. Në mos rastiste nonjë e Diele përpara Motit të Ri, atëherë i kujtojmë Hyjprinderit e sipërme më 26 të Dhjetorit.*

### E DIELA PAS KËRSHËNDELLAVE

(Që më 26 gjer më 30 të Dhjetorit)

### PERLËSHORJA E HYJPRINDËRVE, T. II.

Ungjillëzotji o Josëf, stërgjyshit David të gjitha çuditë; se e pé Virgjëreshën të lindë, se lavderove më Barinjtes, dhe adhurove më Maget,

passi u-lajmerove prej Engjellit. Pra lutju Zotit Krisht Perendí, të shpctohen shpirtet tona.

PERLÇSHORJA E EFTHIMIT TË SARDËS,  
T. IV, QË TROPON METOKHOS

Shok i menýrave, nekembës i fróneve, u-çfaqë kor' e Dishépujve, zbatove me veperím kudó, çdo teorí edhe predikím; perandáj të verteten leçite prer' e drejt, dhe për besën leçtove gjer në gjak, si një Deshmór o Shen Efthím; lutju Zotit Krisht Perendí, të shpctohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Davidin mbretin të gjithë le ta kendojmë sot, si gjysh të Shpctimtarit, se prej tij Virgjeresha, Maria na ka zbritur dhe prej asáj, lindi Krishti çuditerísht, edhe Adamin dhe Even me përdellím, na i ngjalli njeridáshesi.

I pa me sy profetite të plotësúara, në pleqerí Josefí, dhe Jesújt i sherbeu, në shpellen e perunjur në Bethlehém, sipas úrdherit t' Engjejve, që Perendín' e hymnonin se paqen sot, përmi dhen' u fali njëresve.

Vellán' e Krishtit të gjithë le ta kendojmë sot, si Kryepërfít të Zotit, që me vdekje Deshmori, shkëlqeu trimerísht dhe lutet për né, gjithënjë pranë Zotit Krisht, që në një shpelle ka lindur në Bethlehém, për shpctimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. Lavdí Perëndise me të lartat, edhe mi dhënë paqë. Sot Bethlehé-

mi pret até, që rri me te djathten e Atit. Sot Ɖngjçjtc e lavderojnc foshnjcn që lindi: Lavdí Pccndisç mc te lartat, cdhe mi dhenc paqç, dhe ncr njçrczit mircdashje.

### PASVARGJET, T. I, PANEFIMI.

Nc lindjen moj Nenc Shen Marí, tere dheu po dçfrén: Dhurata prita prej Mágeve, qelli shkcl-qén dhe ndrit, ja ku dolli ylli, lavderojnc Ɖngjçjtc, barinjtc lozin me fyçjtc, grazhdi me gas mc pret, si nçc fron qellór që shkrcpetín, ngazellohu, ti moj Nenc Hyjlíndese.

Si drit' e pagánçve po vjen, si nçc rob dhe shcrbetór, i mishcruar prej meje sot, Bir Pccndí dhe Zot, ti o i panismc, Fjal' e bashkçqçnshime, se dçshcrón që t' i pasurósh, gjithe te várferit; ty o mprojtes i te várferve, te kendojmc, Zoti i mcshírave.

Si foshnje moj Nenc kur mc sheh, nc nçc shpell' e nc nçc grazhd, gezohu Zonçc Hyjlíndese, se pccrmi dhenc zbres, te shcrónj Adamin, nga scmundjet që pesón, si hengri helmin e gjárpcrit, cdhe nc gracke ra, dhe prej Zotit jasht' u-syrgjynós, prej Parajscs, cdhe vuan mos mé keq.

LAVDI DHE TANI, T. T. IV. Barinjtc rentnc nc Bethlehém, pccr te shikuar Kryebarinc, dhe e gjetnc Mbrcetin e Kerubímeve, te shtrirc nc grazhdin si foshnje. O Zot lavdí mc ty.

### NDÇNJÇSORET, T. I, TO TAFON SU.

U-bere shcrbetór, i te Lartit pccr Krishtin, dhe

rúajtes Joséf, i Jesújt Perendise, e pate posi birin tent, krijëtarin e qíellit; sot pra mblídhemi, dhe ta kremtojmë kujtimin, dhe të lútemi, të na dhurósh o i Shenjtë, shpëtimin të gjítheve.

### LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

Profetet lart në qell, po kremtojnë me besë, çudinë pa tregím, o Marí Virgjëreshë, se ti të mishtë-rúarin, Perendí për të lindur vjen; Magët besë-ríshët, me Shen Josefín të falen, dhe Davidín mbret, e lajmërojnë Barínjtë, për lindjen e Zotit Krisht.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

Kremëtojnë lart në qell, Davidi Mbreti Profeti, dhe Vlesori Shen Joséf, dhe Shen Jakobi Peshkopi; që të tre, Krishtin e kanë, gjirí nga fisi; pra me gas, e lavërojnë dhe i thërresin, Jesú Krishtit Perendise: Lavdí më ty o Zot i çudirave.

### SHTËPIA

Me vendím të perëndishmë mishërohet i pamishti; pështillet me trup i papështjélluri; merrnisje i panísuri; si foshnjë çfaqet më i madhi i botes; mbahet në peqí, ay që beri gjithësinë. Përandáj gjirinjtë e tij mburren, dhe e lavërojnë, dhe i thërresin Jesú Krishtit Perendise: Lavdí më ty o Zot i çudirave.

### SINAKSARI

Gjithë sot, të Díelen pas Kërshëndéllave, kuj-

tojme Hyjpríndërit e Drejte, Shen Josefin, Vlesorin e Shen Marisc, Shen Jakobin, të vellán' e Krishtit, dhe Davidin Profetin dhe Mbretin.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndí, meshirona. Amín.

### ZBRITËSORET, T. I, ESOSE LAON

*Kendohen Zbritesoret e dyta (B) të Kershendëllave.*

- I - B. Pópullin shpëtój me çudí Krijetari  
 Qemoti kur e teri detin një herë.  
 Dhe taní që lindi prej një Virgjëreshe  
 Na tregój Parajsen pra e lavderojme  
 Si njerí edhe si Perëndí me këngë.
- III - B. Vërna veshin kur këndójm' o mireberes,  
 Unj-e ballen kryelárt' e të paudhit,  
 Ngrërna lart përmi mëkatin e mallkuar,  
 Bëna të patundur me fuqinë tënde  
 Né që të hymnojme besërisht me këngë.
- IV - B. Abakumi përlajmëroj qemoti  
 Përlindjen njëzore prej Shpëtimtarit,  
 Se u-vlërsua të përeshikonte,  
 Dhe me të vërtët' i Bir' i Virgjëreshes  
 E ndriçój dhe e përlindi njëzincë.
- V - B. Falna ndjese për lajthimet dhe mëkatat  
 Neve që po të këndojmë që menatë,  
 Dhe shpëtona o Jesú o mireberes  
 Dhe ndriçona për të gjetur udhën tonë  
 Për të trashëguar lumerín' e qellit.
- VI - B. Thëlle Shen Jonáj nër újërát e detit,  
 Nukë dilte për të qetësuar shqotën.

I plagosur nga shigjetat e armikut,  
Zoti Krisht të lutem mpromë nga re-  
zuket.

Eja shpejt se më ka mbytur plogrimi.

VII - B. Djemat besëmire nuk u-frikesuan,  
Po nga mall' i Perëndisë Mbretit tonë  
E perbuznë úrdherin e një tirani,  
Dhe në mes të flagës i kendonin  
hymne:

I bekuar je o Zot i gjithësisë.

VIII - B. Djemt' e vjeter që prej zjarrit nuk u-  
doqne

Korezuan sheshit lindjen virgjërore  
Të pangár' e të padjegur të Marisë.  
Zotin që ka bërë këtë çudira  
Me mirenjohje pópujt' e lavderojnë.

IX - B. Heshtja është sot m' e lehtë dhe pa frikë;  
Kemi shumë mall po është shumë e rëndë  
T' endim lavderim për ty o Virgjëreshë;  
Po ndriçona dhe sipas dëshirës sonë  
Falna dhe fuqí o Nen' e Shpëtimtarit.

## DERGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Për Shen Jakobin mblídhemi, të vellan' e Zotit  
Jesú Krisht, me Mbretin profetik Davíd, dhe Jo-  
sefin e lumur, Vëlsorin e Virgjëreshës, se në lind-  
jen e Krishtit, në Bethlehém dhe në Judé, në një  
shpellë shërbyen të gjithë tok, me tre Maget En-  
gjejtë dhe Barinjte, dhe e kendonin me lavdí,  
Shpëtimtarin dhe Zotin.

T. III. Na veshtró j qe lártazi, nga qelli Shpetimtari Krisht, lindja e lindjeve, dhe né te vérberit ne pus, pame te drejten fáqeza, se ja prej Virgjereshes, na lindi i Madhi Zot.

#### LAVDERIMET, T. IV.

Defreni o te drejte, ngazellohu o qíell, këceni o male, se lindi Krishti. Virgjerasha rri si nje Engjell, dhe mban ne peqí Perendine e misheru-ar. Barinjte e lavderojne, Maget i blatojne dhurata, Engjeyte e perhymnojne dhe thone: Zot i çudiçim lavdí me ty.

Ati e gjeti te pelqyer, Fjala u-misheru-a, Virgjerasha lindi, Perendine qe u-be njerí. Ylli e lajmerón, Maget e adhurojne, Barinjte çuditen, e-dhe krijesa ngazellohet.

O Virgjereshë Hyjlíndese, qe linde Shpetimtarin, dhe permbyse mallkimin e Eves. Pra te lavderojme me besë, dhe therresim dhe thomi: O Zot i çudiçim lavdí me ty.

Ejani ta perhymnojme, Nenen e Shpetimtarit, Virgjereshen e pacinuar. Gezohu o pallát i Krishtit, i Perendise dhe i Mbretit. Nermjetó perpara Birit, per shpetimin e besníkeve.

LAVDI, T. T. IV. Gjak dhe zjarr, edhe avull dhe tym, djaj dhe drangónj, Shen Joeli parethá: gjak per Krishtin njerí; zjarr per Krishtin Perendí; edhe avull dhe tym per Shpirtin Shenjt, qe zbriti mi Virgjereshen dhe mi Apostujte, edhe

pastáj mi tere boten. Misteri i mishërimit është i math. O Zot lavdí me ty.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Virgjeshë. Të hymnojme, se prej Birit që linde, Ferri u-roberua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe né múarme jetë. Perandáj po hymnojme dhe thërresim: I bekuar je o Krisht Perendí, që e pelqeve keshtú lavdí me ty.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS

Virgjresha lindi sot, të permiqénshimen Fjale, edhe dheu i blatón, të paafrúarit shpellen; Engjete, me Barinjte po lavderojne; Maget pra, bashkë me yllin po udhetojne; se për né ka lindur Krishti, si djale foshnje, i parejétshimi Zot.

### APOSTULLI

Perendia ka bërë çudira me Shenjtorët. Bekójeni Perendinë në Kishët.

Prej Letres së Palit për Gallatianët.

Vellezer, ju bënj të njohur se Ungjilli, i predikuar prej meje, nuk është prej njeriu. Se as e kam marrë as e kam mësuar nga nonjë njerí, po vetëm nga revellata e Jesú Krishtit. Se e kini degjuar sa ngushtë isha lidhur me Judaizmen, edhe sa repte e kam ndjekur, dhe e kam leftuar Kishën e Perendisë. Dhe përparonja në Judaizmen më tepër se moshataret e gjindjes sime, edhe isha zelltár i flakte i tradítave të mia atërore. Po kur i pelqeu Perendisë, i cili më kishte

caktuar që nga barku i nënës sime, dhe me thirri me hirin e vetë, edhe ma revelló j të Birin, dhe me porrositi ta ungjillezón j nër kombet, nukë mora këshille nga nonjë njerí i gjallë, as vajta në Jerusalém që të píqesha me atá, të cilet kishin qënë Apostú j përpara meje, po shkova menjëherë në Arabí, dhe pastá j u-ktheva në Damaskë. Pastá j, pas tre vjeç, u-ngjita në Jerusalém që të shikonja Pjetrin, dhe ndenja me atë një pesëmbëdhjetë ditë. Dhe përveç Jakobit, të vëllá j të Zotit, nukë kam parë nonjë tjetër prej Apostujve.

### UNGJILLI PAS MATTHEUT

Passi shkuan Maget, ja ku Engjelli i Zotit iuduk Josefít në enderr, dhe i tha: “Ngrëhu, dhe merr-e djalin dhe t’ emen, dhe shko në Egíptë, dhe qëndró atjé gjer sa të të them, se Herodi do ta kerkonjë djalin që ta vrasë.” Dhe Josefi, e mori djalin dhe t’ emen natën, dhe shkoj në Egíptë, dhe mbeti atjé gjer sa vdiq Herodi, që të mbushet fjala, e thënë prej Zotit me anën e Profetit: “E thirra tim bir prej Egíptes.” Atëherë Herodi, kur pá se Maget e genjyen, u-zemërua fort, edhe dërgó j, edhe i theri të gjithë çiliminjtë në Bethlehém edhe në qarkun rotull që prej dy vjeç e poshtë, si pas kohës që i lajmëruan Maget. Atëherë u- mbush fjala, e thënë prej Profetit Jeremia: “Një zë u-degjua në Ramá, një vajtím, një qarje dhe një lebetí e madhe. Rakela vajtón për femijet, edhe nukë munt të ngushellohet, se nuk i ka mé.”

Po kur vdiq Herodi, ja ku Engjelli i Zotit iu-duk në enderr Josefit në Egjiptë, dhe i tha: “Ngrehu, dhe merr-e djalin dhe t’ emen, dhe kthehu në dhene e Israelit, së atá, që kerkonin ta vrisnin djalin, kanë vdekur.” Dhe Josefi u-ngrit, e mori djalin dhe t’ emen, edhe u-kthye në dhene e Israelit. Edhe kur degjój së Arkellau mbretëronte mi Judene si nëkembes i Herodit, të cilin e kishte átë, pati frikë të shkonte atjé, dhe i lajmëruar prej Engjellit vajti në qarkun e Galilese. Dhe shkoj, edhe banój në një qytét, të quajtur Nazarét, që të mbushet fjala, e thënë prej Proféteve, që do të quhet Nazareas.

27. *Shën Stefani; Theodori i Shkruar.*

PERLESHORJA E THEODORIT TË  
SHKRUAR, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tënt, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesim, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Engjëjtë, o Theodór i lumur lavdí me ty.

PERLESHORJA E SHËN STEFANIT,  
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Kurore prej Mbreti ke, mi koken o Shën Stefán, për vojtjet e tmërrshime, për Zotin tonë Jesús, i Par’ i Dëshmorëve; se ti i kallëzove, marrësít’ e Judenjve, dhe e pé Shpëtimtarin, me të

djathten e Atit. Atjë pra nermjetó gjithenjé, te shpëtohen shpirtet tona.

### THRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ndrite me Shpirtin Shenjt, si Ëngjell nga fytyra, dhe fjalet e Ungjillit, degjónjesve u çfaqë, Dëshmór i Par' o Shen Stefán.

Hipe në qiëllin, qëndrove me të djathtë, përpara Perëndisë, dhe more sipas vlerës, kuroren e Dëshmoreve.

Vrásësit i bekón, me gurë kur të vrisnin, dhe për atá po falesh, edhe i ndjen si Krishti, dhe lart në qell po fluturón.

LAVDI. O Shen Stefán Dëshmór, i Par' i Shpëtimtarit, për shpirtet tona lutu, perkrahna shiguron, Parajsen e Shenjtóreve.

TANI. Krishtin në Bethlehém, na lindi Virgjresha, dhe Ëngjëjte këdojnë, lavdí për Perëndinë, dhe paqe dhe bekím mi dhé.

### PASVARGJET, T. I, TON URANION

Até që lindi prej Atit përpara jéteve, dhe ish në gji të Atit me Trinín' e pandarë, Maria sot e mban si bir në peqí, si mi fronin e tij qëllór, edhe Barinjte me Ëngjëjt' e Magët tok, po i falen me lavderím.

Në Bethlehém të Judesë, eni shikójeni, até që bëri botën, të vendosur mi grazhdin, prej Mágeve dhurata pret me lavdí, që me yllin ia síëllin,

si Perendí dhe si Mbret edhe si njerí, i shkëlqyer q' u-shtri në varr.

Prej Virgjereshes dhe Nenes linde në shpell' e grazhd, dhe Forcat Engjellore, të therrisin me bujë: Lavdí me ty o Zoti Krisht Perendí, se na linde si një njerí, prej Virgjereshes Hyjlíndese Shen Marí, për shpetimin e besnikëve.

#### LAVDI DHE TANI, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ndrite me Shpirtin Shenjt, si Engjell nga fytyra, dhe fjalet e Ungjillit, degjónjesve u-çfaqë, Deshmór i Par' o Shen Stefán.

#### NDENJESORET, T. I., TON TAFON SU

Dishepull i Jesújt, ti o Dhjaku i parë, i pari po deshmón, për Jesunë dhe besën, dhe botën po e ndriçón, me mesimet e Shkrónjave, dhe po i shcrón, lengatat tona me shenja, pra të lútemi, prej çdo reziku shpetona, Stefán i kuróreve.

#### LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

#### T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Dyke patur frymesím, prej Shpirtit Shenjt mistikerísht, dhe prej Zotit Jesú Krisht, Deshmór i Parë Shen Stefán, i ke qertuar Judenjtë sipas Shkriptúrave, dhe sheshit u tregón, si lindi Krishti permi dhé, si rodhi drejt për drejt, që prej Davidit Mbret, i mbushur plot me hir dhe urtesí i lavderúari. Stefán i lumur, mprona dhe falna, ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI. I panxeni Perendí, si na

u-nxu në gji tani? Birin Zotin pa kufi, si e mban Nena në peqi? Pa fjal' e deshi vetë dhe ashtu e beri. Se nukë kishte trup, dhe mori trup vullnetarisht, edhe u-bë aý që ish si nukë ish për botën. Me dy natyra, na lindi Krishti, që t' i shpëtonjë njërczit.

*Meqëneqe nukë ka Ungjill të Mengjezit, këndohet mënjehere:*

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

Die lindi Zoti Krisht, mi dhënë zbriti prej qellit, kur besniku sot na vdiq, u-ngjiti në qellin prej dheut; ja një Mbret, brenda në shpëllën, si foshnjë dërgjet; ja një Shenjt, me gurë vritet si një keqberes, po kështu kurërezohet, Stefán' i Pari Deshmór i Zotit Krisht.

### SHTËPIA

Si yll i shkelqyer në ndriti sot me lindjen e Krishtit i Pari Deshmór, Shen Stefani i lumur, i cili proklamój përpara Judenjve që Jesúj, i lindur prej Virgjërshes është Krishti, i lajmëruar prej Profëteve, dhe përandáj i trashëgój lumëritë qëllorë, dhe nermjetón për né pa pushuar Shen Stefani, i Pari Deshmór i Zotit Krisht.

### SINAKSARI

Me njëzét e shtatë të keti múaji, kujtojmë Shen Stefanin, Deshmorin e Parë, Apostullin dhe Kryedhjakun.

Gjithë sot, kujtojmë Theodorin e Shkruar, Atin

tone Oshenár, te vellán' e Theofanit Vjershetorit.

Gjithe sot, kujtojmë Shen Theodorin, Atin tone Oshenár, kryepeshkopin e Kostandinopojës.

Gjithe sot, kujtojmë Mavriqin, Hierodeshmorin e Shenjte me shoket, te Shtatedhjetë Dëshmoret.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

### ZBRITËSORET, T. I, ESOSE LAON.

*Kendohen Zbratesoret e dyta (B) te Kershendéllave.*

- I - B. Pópullin shpëtój me çudí Krijetari  
 Qemoti kur e teri detin një here.  
 Dhe taní që lindi prej një Virgjereshe  
 Na tregój Parajsen pra e lavderojmë  
 Si njerí edhe si Perendí me kenge.
- III - B. Verna veshin kur kendójm' o mireberes,  
 Unj-e ballen kryelárt' e te paudhit,  
 Ngrerna lart permi mekatin e mallkuar,  
 Bena te patundur me fuqine tende  
 Né që te hymnojme beserisht me kenge.
- IV - B. Abakumi parelajmerój qemoti  
 Perlindjen njerezore prej Shpëtimtarit,  
 Se u-vlerësua ta parëshikonte,  
 Dhe me te vertét' i Bir' i Virgjereshes  
 E ndriçój dhe e perlindi njerezine.
- V - B. Falna ndjese per lajthimet dhe mekatat  
 Neve që po te kendojmë që menate,  
 Dhe shpëtona o Jesú o mireberes  
 Dhe ndriçona per te gjetur udhen tone

Per te trashëguar lumërin' e qellit.

VI - B. Thelle Shen Jonáj ner újerat e detit,  
Nuke dilte per te qetesuar shqoten.  
I plagosur nga shigjetat e armikut,  
Zoti Krisht te lutem mprome nga re-  
zuket.

Eja shpejt se me ka mbytur plogerimi.

VII - B. Djemat besemire nuk u-frikesuan,  
Po nga mall' i Perendise Mbretit tone  
E perbuzne úrdherin e nje tirani,  
Dhe ne mes te flages i kendonin  
hymne:

I bekuar je o Zot i gjithesisë.

VIII - B. Djemt' e vjeter qe prej zjarrit nuk u-  
doqne

Korezuan sheshit lindjen virgjeroe  
Te pangár' e te padjegur te Marise.  
Zotin qe ka bere ketó çudira  
Me mirenjohje pópujt' e lavderojne.

IX - B. Heshtja eshte sot m' e lehte dhe pa frike;  
Kemi shume mall po eshte shum' e rende  
T' endim lavderim per ty o Virgjereshe;  
Po ndriçona dhe sipas deshires sone  
Falna dhe fuqí o Nen' e Shpetimtarit.

### DERGIMËSORET, T. III, EPESKEPSATO

Shen Stefani ra Deshmór, i pari prej Dishé-  
pujve, edhe u-ngjit ne qíellin, perpara Krishtit  
me lavdí; dhe pa pushim po nermjetón, tu fale  
njerezise, Parajsen e Çngjejve.

Na veshtró j qe lártazi, nga qelli Shpetimtari Krisht, lindja e lëndjeve, dhe né te vérberit ne pus, pame te drejten fáqeza, se ja prej Virgjeshes, na lindi i Madhi Zot.

### LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Kurore lulësh mendore éjani mpléksini, atí qe ish i pari, qe deshmo j per Jesunc, dhe qellin e shiko j te hapur dhe qendro j, me te djathten e Zotit Krisht, dhe u-çpagua ashtú siç e merito j, me kuroren e Deshmóreve.

Stefán i Shenjte i pari midis Deshmóreve, dhe dhjákerve te Krishtit, nermjetó per besniket, perpara Shpetimtarit Zotit Jesú, ti o shoku i Engjerve, edhe na fal te gjítheve perdellím, edhe ndjese te mekátave.

U-shenjterove i pari i vrare si Deshmór, prej guresh qe i prite, me kuráj' e me mburrje, dhe vráscsit i ndjeve me perdellím, dhe u-ngjite ne qíellin, dhe nermjetón pa pushuar pranc Jesújt, per shpetimin e besníkeve.

LAVDI, T. T. I. O Deshmór i Parc, Apostúll dhe Kryedhják, lavdí e te dréjteve, e pé te hapur qellin ne arenc, dhe Krishtin me te djathten e Atit, edhe ndrite si Engjell nga fytyra, dhe i fale atá qe te vrisnin me gurc. Pra taní te lútemi, nermjetó per né perpara Jesú Krishtit, te na dhuronje ndjescn e mekátave, dhe Parajscn e Shenjtóreve.

TANI. Krishtin ne Bethlehém, na lindi Vir-

gjerresha, dhe Engjete kendojne, lavdi per Perendine, dhe paqe dhe bekim mi dhe.

### SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

Virgjresha lindi sot, te permiqenshimen Fjale, edhe dheu i blaton te paafruarit shpellen; Engjete, me Barinjte po lavderojne; Maget pra, bashke me yllin po udhetojne; se per ne ka lindur Krish-ti, si djale foshnje, i parejateshmi Zot.

### APOSTULLI

Fama e tij u-perhap ne tere boten. Qelli tregon lavdine e Perendise.

Prej Akteve te Apostujve.

M' ato dite, Stefani, plot me besë dhe me for-cë, po bente çudira te medha perpara popullit. Edhe disa prej sinagojes te Libertineve, Kirine-asve, Aleksandrineve, Kilikianeve dhe Asianeve vajtin per te biseduar me Stefanin, po nuke muntnin ta perballnin urtesine dhe Frymen, me te cilen fliste. Athere vane ca njerës te paguar dhe deshman: "E kemi degjuar te thote blasfe-mira kunder Moisiut edhe Perendise." Edhe e shtyne popullin dhe Kryepleqte dhe Shkronjesit, edhe arthne, dhe e rembyen, dhe e shpune per-para keshilles. Edhe vune deshmorë te reme, te cilet thane: "Ky njeri nuke pushon se foluri blas-femira kunder keti vendi te shenjte dhe kunder ligjes, se e kemi degjuar te thote se Jesu Naza-reasi do ta prishe ketë vent, edhe do t' i ndronje

zakonet, qe na ka dhene Moisiu.” Edhe pjesctaret e keshilles i kthyen syte, dhe pane se fytyra i ndritte si fytyre prej Engjelli. Edhe Kryepriifti e pyeti: “A jane te verteta ketó?” Dhe Stefani u-pergjéq: “Burra vellezer dhe ater, degjómeni. Perendia iu-duk atit tone Abraham, kur ishte ne Mesopotami, dhe i tha: Shko nga kjo toke dhe nga gjirinjte e tu, dhe eja ne dhene qe do te tregónj. Edhe ay shkoj nga dheu i Haldeancve, dhe banój ne Harrán. S’ andejmi, si vdiq i ati, e vendosi ne dhene, ku banón tani; dhe nuk i dha asnjé çap toke per trashegím. Edhe Sollomoni i ndertój nje tempull. Po Perendia nuke banón ne tempuj, te bere praj dore njerczore, sikunder tha Profeti: Qellin e kam fron edhe dhene shesh per kembet; cili do me ndertoje shtepí, thote Zoti, edhe ku eshte vendi ku do te prehem? Valle nuk i ka bere dora ime te gjitha ketó? Kokeforte dhe te pagdhendur nga zemra dhe nga veshet, ju e kundershтони Shpirtin e Shenjte gjithenjé, si Aterit tuaj, edhe ju. Cilin prej Proféteve nuk e kane ndjekur áterit tuaj? Gjithashtú i vrane te gjithethe atá, qe parclajmeruan ardhjen e te Drejtit, te cilin ju e tradhetuat edhe e vrate. Gjithashtú e kini marre ligjen me porrosira engjellore, dhe nuk e kini rúajtur.” Dhe kur i degjonin ketó, u sharrohej zemra, dhe ia kerzellenin dhembet. Edhe ay, plot me Shpirtin e Shenjte, i ngriti syte ne qell, e pá lavdine e Perendise, dhe Jesune me te djathten e tij, edhe tha: “Ja ku e shoh qe-

llin të hapur dhe të Birin e njeriut me të djathten e Perendisë.” Dhe atë bertitne me zë të math, i mbyllne veshet, edhe u-sulne të gjithë tok mi atë. Edhe e nxuarne jashtë qytetit, edhe i hithnin gurë; edhe deshmoret i vendosne robot në kembet e një djaloshi, të quajtur Saúl, edhe i hithnin gurë Stefanit, i cili falej edhe thoshte: “O Zoti Jesú Krisht, pritma shpirtin.” Dhe pasi ra me gjunjë, thirri me zë të math: “O Zot, mos ua ngarkó këtë mekát.” Dhe pasi tha këtë fjale, fjeti.

### UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti tha këtë parabolë: Ishte një zot prej shtëpie, i cili mbolli një vreshtë, dhe e thuri me një garth, edhe mihi një tire në atë, edhe ndertój një pirk, edhe ua dha disa bujqve, dhe shkoj në mërgim. Dhe kur u-afua koha e pemeve, u dergój bújqerve sherbetoret për të marrë pemtë. Po bújqerit i zunë sherbetoret, edhe cilin e rrahne, cilin e vranë, dhe cilin e lapiduan. Zoti dergój perserí të tjere sherbetore, më shumë se të parët; po bújqerit ua bënë edhe atyre gjithashtú. Më në fund u dergój të birin, dyke thënë: “Do të kenë turp nga im bir.” Po bújqerit, kur e panë të birin, thanë me veten e tyre: “Ky është trashëgimtari. E jani ta vrasim, edhe tja zaptojmë trashëgimin.” Edhe e zunë, dhe e nxuarne jashtë vreshtes, edhe e vranë. Kur të kthehet i zoti i vreshtes, vallë çdo tu benjë atyre bújqerve? Edhe atë iu-përgjeyne: “Keq e më keq do t’i humbasë të liqtë,

edhe vreshten do tua japë bújqerve të tjera, të cilët do t'ja kthejnë pemet në kohen e tyre." Edhe Jësúj u tha: "A e kini kënduar nonjë here në Shkripturat që Guri, të cilin e çperhojnë nder-tónjesit, aý u-vu në krye të çipit? Kjo veprë është bërë prej Zotit, edhe është e çudíçime në sytë tanë."

28. *Te Dy Mijë Deshmoret, që u-dogne në Nikomedí.*

29. *Foshnjat e Shenjta, që u-therne prej Herodit në Bethlehém; Markeli, Ati ynë Oshenár, Abati i Manastirit të Pafjëturve.*

30. *Anisia, Deshmorja e Shenjte dhe Oshenare.*

31. *Mellana e Romes, Nena jonë Oshenare.*

## TE KREMTET E JENARIT

1. *Rethprerja e Zotit tone Jësú Krisht; Shen Basili i Math, Ati ynë i Shenjte, kryepeshkopi i Kesarise së Kapadokisë.*

### PERLËSHORJA E SHEN BASILIT, T. I.

Në tërë dhënë doli fama jote, se ajo ka pritur fjalën tënde, kur përhapë dogmat e perëndishme, madheshtove natyrën e gjërave, riformove zakonet e njërësve, Shen Basil Kryeprift, Atë Oshenár, lutju Zotit Krisht Perëndí, të shpëtohen shpirtet tona.

### PERLËSHORJA E RETHPRERJES, T. I, TU LITHU SFRAGISTHENTOS

Fytyrë njerezore më pa u-ndryshuar, mi natyrën e perëndishme, o Zot i zemërdhempshur;